

Xhafer Martini

KUJTIM FRANGU

Jetë e ndërpërre për jetën

Tiranë, maj–qershori 2004

Redaktor:
Isuf Neli

Recenzentë:
Shefki Çupi
Isuf Neli

Kopertina:
Elsa Martini

© Të gjitha të drejtat të autorit

**Libri u sponsorizua nga familja
e Kujtim Frangut**

Shtëpia Botuese: "Afërdita"

Tiranë, maj – qershor 2004

HYRJE

Para se të filloja të shkruaja për Kujtim Frangun, kisha njëfarë hezitimi. E dija që ishte vrarë në qendrën e votimit, në vitin 1997, në zgjedhjet për në Kuvendin Popullor, në fshatin Lis të Matit. Në atë kohë kjo ngjarje nuk pati jehonën që duhej në median e shkruar dhe elektronike. Mbase për shkak të mungesës së informacionit, mbase për shkak se çdo ditë ndodhnin ngjarje të tillë të rënda. Por edhe sikur jehona të kishte qenë e madhe, unë prapë do ta kisha atë ngurrimin, që nuk kishte të bënte thjesht me Kujtim Frangun. Kam njojur mjaft komisionerë gjatë viteve të pluralizmit politik. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë njerëz të nderuar dhe e kanë kryer me përgjegjësi detyrën e ngarkuar. Por ka pasë edhe prej atyre që janë bërë vet shkak për shpërdorimin e votës së lirë. Nuk përashtohej mundësia që edhe Kujtim Frangu të kishte qenë i tillë.

Por lumturisht qe e kundërta. Duke u njojur me jetën

e Kujtim Frangut, me veprimtarinë e tij politike e shoqërore, me fëmijërinë dhe rininë e tij të hershme, me familjen e tij, mësova me kënaqësi se ai ishte njeriu më shembullor, demokrati më model, djalosh i përsosur, i ndershëm dhe serioz, zemërmirë, fjalëmbël, me marrëdhënie të shkëlqyera me të gjithë ata që kishte të bënte.

Edhe pse në të kaluarën diktatoriale kishte vuajtur shumë, zemra e tij nuk ishte prekur nga e keqja, shpirti i tij kishte mbetur i kulluar. Ajo natyra e tij prej njeriu të mirë, nuk kishte ndryshuar aspak. Të gjithë ata që kam takuar, më kanë folur fjalët më të mira për Kujtim Frangun. Këtë e kanë bërë dhe kundërshtarët e tij politikë.

Një njeri me këtë substancë morale, me këtë formim njerëzor nuk mund të shkonte në qendrën e votimit për sherre dhe grinde, nuk kishte asnjë dëshirë për manipulime, veç për drejtësi dhe ndershmëri. Ai nuk ishte nga ata që do t'i gëzohej një fitoreje me vota të vjedhura, një fitoreje, të cilën nuk ta jep populli, të paktën pjesa më e madhe e tij. Por ai as nuk do të lejonte që të tjerët ta shpërdoroni votën e popullit. Këtë nuk do ta bënte me forcë fizike, por me arsyé dhe me forcë morale.

Përveç njohjes së drejtpërdrejtë, që ishte e pamundur, realizova pothuaj të gjitha llojet e tjera të njohjes. Tashmë hezitimi për të shkruar për Kujtim Frangun lidhej me

ndjenjën e përgjegjësisë, pasi ndodhesha para një personaliteti të pabujshëm, por që me jetën e vet dhe, veçanërisht me rënien, na mëson shumë.

Gjatë punës për librin figura e Kujtim Frangut rritej brenda ndërgjegjes sime krijuese dhe njerëzore. Kujtimet për të ishin si një fotografi e grimcëzuar që e ka shpërndarë era. Duhej t'i mblidhja ato copëza, t'i bashkoja dhe të formoja të tërën. Por, sado mjeshtëri të tregosh, “origjinalja” nuk është kurrë e njëjtë me “të ribërën”.

Me këtë metaforë dua të them se Kujtim Frangu i librit tim do të jetë mjaft i zbehtë se sa Kujtim Frangu i gjallë. Por këto janë gjëra që lexuesi i fal.

Iu futa punës për ta shkruar këtë libër jo thjesht si një akt moral ndaj Kujtimit dhe familjes së tij, por edhe për një arsyet tjetër, më madhore: çështja për të cilën Kujtim Frangu ra, është edhe sot aktuale. Prandaj le të jetë ky libër jo vetëm një homazh për Kujtim Frangun në shtatëvjetorin e tij të vdekjes, por edhe një apel shoqëror për të mos shkelur më mbi gjakun e të rënëve, të atyre që kanë flijuar jetën për të mirën e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar.

MATI, VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Mati është një trevë shqiptare nga më të lashtat. Për vetë pozicionin e saj gjeografik, për tokat pjellore dhe malet e veshura, për nëntokën e pasur, për ujërat dhe burimet, për kushtet e favorshme klimaterike dhe tokësore etj., është banuar qysh në muzgun e historisë.

Rrethi i Matit ka një sipërfaqe prej 1028 kilometra katrorë dhe mbi 70000 banorë, pjesa më e madhe e të cilëve jetojnë në fshatra. Qytetet janë Burreli, Klosi dhe Ulëza. Lugina e Matit, me gjatësi 100 kilometra dhe me gjerësi deri në 20 kilometra, është fusha më pjellore në këtë trevë. Në lashtësi kufijtë e Matit kanë qenë mjet më të hapur në krahasim me të sotmit.

Nga pikëpamja etnografike, Mati ndahet në katër zona, që kanë dallueshmëri kulturash e traditash, por jo të mëdha. Këto zona janë: Rranza, Prelli, Pertejuji dhe Kryematja.

Mati në lashtësi është banuar nga fisi ilir i Albanëve. Për prejardhjen e emrit Mat ka mendime të ndryshme.

Më i respektuar prej tyre duket ai që e ka shfaqur Çabeji, i cili këtë emër e lidh me breg lumi, breg deti etj. Por ka mendimtarë të tjerë, të huaj më parë, duke filluar qysh në shekullin XIII, pastaj vendas, në shekullin XV e këtej, që për prejardhjen e emrit Mat kanë mendime të tjera.

Në Mat procesi i islamizmit të popullsisë vendase ka ndodhur më vonë se në krahinën fqinje, në Dibër. Ky islamizëm në Mat nuk pati përhapje të gjerë, nuk e përfshiu tërë trevën dhe nuk eci me ritme të shpejta. Në këtë trevë, ashtu si kudo ku u përhap, islamizmi i popullatës nuk u bë me dhunë, me forcë, por me dëshirë, pa mohuat këtu dhe interesat. Një nga shkaqet përsë matjanët përqafuan fenë e re, është i karakterit atdhetar. Ata dëshironin “të distancoheshin” edhe nga ana e fesë prej fqinjëve të tyre të krishterë: serbëve dhe grekëve, që kishin qëllime asimilimi dhe shkombëtarizimi ndaj shqiptarëve. Kjo nuk do të thotë aspak që pjesa e popullatës që nuk u islamizua, ishte më pak atdhetare.

Matjanët nderohen për luftërat që kanë bërë kundër të gjithë pushtuesve. Mati është i pasur me kala. Ai ka një kulturë të lashtë materiale dhe shpirtërore që vërteton autenticitetin dhe iliricitetin e krijuesve të saj. Mati ka shumë kulla karakteristike, që shpesh janë shndrruar në kala të pamposhtura. Në Mat është prodhuar baruti. Matjanët e

kanë prodhuar për ta djegur vetë, por edhe për tregti.

Mati ka nxjerrë burra të shquar që kanë pasë ndikim në historinë tonë kombëtare. Matjanët kanë pretendimin se Skënderbeu është matjan. Një pretendim të tillë e kanë edhe dibranët. Në të dyja këto treva ka gjurmë të pashlyeshme të Heroit; të dyja kanë derdhur aq shumë gjak për liri e pavarësi, sa, edhe pa asnje pretendim mbi Skënderbeun, janë të lavdishme. Mati ka meritën se ka nxjerrë nga gjiri i tij Mbretin e Shqiptarëve, Ahmet Zogun. Sadoqë u përbalt për gjysmë shekulli, figura e tij çdo ditë e më shumë merr një ndriçim të ri. Ai tashmë u takon atyre personaliteteteve që e kanë kaluar provën “e zjarrtë” të historisë. Mati ka nxjerrë edhe shumë burra të tjerë të shquar, me të cilët nderohet dhe krenohet. Ko trevë ka luftuar për liri dhe demokraci. Luftërat i ka bërë të përbashkëta me krahinat fqinje. Kjo e nderon. Kudo ku ka krisur pushka për atdhe, matjanët kanë vrapuar. Nuk kanë pritur ftesa.

LISI

Njëra prej katër zonave etnografike të Matit është edhe ajo e Pertejuit, me dallime joësenciale prej zonave të tjera në dialektin gjuhësor, në veshje, zakone, tradita, kulturë jetese etj. Në këtë zonë bëjnë pjesë fshatrat në krahun e djathtë të rrjedhës së lumbit të Matit. Midis këtyre është edhe Lisi, një nga më të hershmit në të gjithë Matin, populluar qysh në lashtësi. Ka pasë një nivel ekonomik të lartë për kohën, një kulturë dhe një mënyrë jetese për t'u admiruar. Lisi ka qenë qendër e rëndësishme administrative, fetare, tregtare, arsimore, nyjë rrugësh dhe komunikacioni. Ka qenë një qytet i zhvilluar gjurmët e të cilët dijetarët i shikojnë tek Stellushi.

Regjistri Osman i vitit 1467, i njojur si Defteri Turk, i hartuar nga administrata perandorake për vjeljen e taksave në Vilajetin e Dibrës, e përmend emrin e Lisit si fshat me 9 shtëpi, por me formën Litz. Lisi ishte “porta” e Matit për në Dibër dhe më gjerë.

Zhvillimi i një vendi varet shumë nga tregtia e tij. Në Lis të dielën shkonin për të bërë pazar jo vetëm fshatrat e Matit, por edhe treva të tilla si Lura, Mirdita, Dibra etj. Dibranët në të kaluarën e hershme kanë pasur shumë lidhje me Lisin. Në një këngë popullore, nga ato që e marrin temën nga përgatitja e nuses për dasmë, ka disa vargje ku është përjetësuar pazari i Lisit, se pikërisht atje janë blerë petkat e nuses:

“Ato shamijat për mjedisit
Nuse, kush t’i ka dhanë”
- I kam ble në pazar të Lisit,
Nanë, o mori nanë!”

Lisi ka qenë vatër e dorës së parë në fushën e arsimit në krejt Matin. Lizdanët janë arsimdashës dhe kulturëdashës. Ata kanë prirë në fushën e diturisë. Në Lis është hapur shkolla e parë shqipe në rrithin e Matit dhe një ndër të parat edhe në shkallë kombëtare.

Treva e Matit pothuaj nuk e ka humbur kurrë lirinë për shkak të sundimit osman. Turqit rrallë kanë depërtuar në thellësi të sajë dhe, kur kjo ka ndodhur, nuk kanë ndejtur për një kohë të gjatë, se janë përzënë nga popullsia trime. Mati ka dhënë kontributin e vet për shpalljen e Pavarësisë sonë Kombëtare me 28 Nëntor 1912, ndonëse matjanët

praktikisht kishin qenë të lirë. Por ata nuk mjaftoheshin me një liri formale, nuk kishin si ta ndjenin dhe ta preknin lirinë pa qenë të organizuar në shtetin e vet kombëtar, pa bërë një jetë të përbashkët kombëtare. Ndjenja shtetare tek matjanët është e fuqishme.

Në praghpalljen e Pavarësisë, dom Nikollë Kaçorri, që njihej ma matjanë dhe gjëzonte besimin e tyre, i porositi që, me t'u ngritur flamuri në Vlorë, ta ngrinin atë edhe në Mat, si një veprim atdhetar jo thjesht me karakter simbolik, por edhe me vlerë të madhe politike, pasi treva bëhej edhe “de jure” pjesë e Shqipërisë së Pavarur, pavarësisht se kjo pavarësi u shpall, për rrëthanat e kohës, në një pjesë shumë të cunguar të Shqipërisë Etnike. Ngritja e flamurit në Mat nuk ishte thjesht shkëputje nga Perandoria Osmane, por edhe një akt që ia “vente kufirin tek thana” Serbisë që aq shumë lakmonte toka shqiptare.

Në nëntor të vitit 1912, pak ditë para se të shpalloj Pavarësia në Vlorë, Dibra ra nën pushtimin e egër serb. Në atë kohë qe rrrethuar edhe Shkodra nga forca të shumta malazeze dhe serbe, pasi krali i Malit të Zi donte ta bënte qytetin shqiptar kryeqytet të vendit të tij, siç pretendonte se kishte qenë në të kaluarën e hershme. Në ndihmë të Shkodrës së rrrethuar shkuan edhe dibranët, edhe matjanët. Midis matjanëve kishte shumë lizdanë.

Kërcënimi i serbëve nga Shkodra do të vinte edhe në

Mat, prandaj këtyre luftëtarëve natyralë iu desh të luftonin me trimëri, me heroizëm dhe pa ndërprerje që nga viti 1912 deri në vitin 1920 nën udhëheqjen e Ahmet Zogut. Në të gjitha këto luftëra kanë dhënë kontributin e vet të çmuar edhe lizdanët.

Lizdanët, ashtu si gjithë matjanët, e pritën me armë edhe Italinë fashiste që pushtoi vendin tonë me 7 prill 1939. Asnjëra prej familjeve të mëdha dhe të përmendura të Matit nuk ndejeti në shtëpi për t'iu nënshtuar pushtuesve italianë, por morën malet.

Lizdanët do të ishin në ballë të luftës kundër pushtuesve italianë, që populli i Matit e bëri nga 31 korriku i vitit 1943 deri në shtator të atij viti. Në këtë luftë janë treguar faqe të ndritshme heroizmi popullor.

FAMILJA FRANGU

Në Defterin Turk të regjistrimit të vitit 1467, në fshatin Lis të Matit ndër nëntë kryefamiljarët që shënohen, përmendet edhe Marin Franku (Frangu). Nuk jemi të sigurt që ky ishte i pari i shtëpisë së Frangajve, pasi mund të ketë pasë shumë të tjera para tij. Por, edhe sikur ky Marini të ishte i pari fare, dera e Frangajve është e lashtë dhe me vazhdimësi në ato troje, derisa ka ardhur deri në ditët tona.

Kujtimet e Tofik Frangut mbërrijnë tek Nuredin Frangu që ka jetuar katër breza më parë. Nëse ndërrimi i brezave bëhet në çdo 30 vjet, i bije që Nuredini të ketë jetuar 120 vjet më parë. Në këtë kohë, siç duket, ka përfunduar procesi i islamizmit të popullsisë në trevën e Matit.

Jo vetëm duke filluar nga Nuredin Frangu, por edhe një shekull më parë, Frangajt, si të gjithë matjanët që u islamizuan, u kthyen në besimtarë myslimanë. Mosnjohja

e Frangajve që nga Marin Franku, katolik, e deri tek Nuredin Frangu, një periudhë prej tre shekujsh, sigurisht lidhet me mungesën e dokumentacionit dhe moshkrimin e gjuhës shqipe si mjet për ta kriuar këtë dokumentacion. Por vazhdimësia e Frangajve është më se e qartë. Nuredin Frangu, i pari i Frangajve myslimanë, pati dy djem: Hasanin dhe Jakupin (Çupin). Hasan Frangu pati dy djem: Nuredinin (Nuren), më i madhi, dhe Tofikun, Nurja ka katër djem: Hasanin, Lazamin, Hamdiun, Rrahmanin, dhe 3 vajza: Ishen, Baften dhe Serveten. Tofikut i lindën shtatë fëmijë, pesë djem dhe dy vajza. Djemtë quhen: Kujtim, Shkëlqim, Bajram, Astrit dhe Jakup, kurse vajzat: Kimete dhe Peme. Tofik Frangu i ka fëmijët nipër dhe mbesa tek Pashajt e fshatit Gjoçaj të Matit.

Tofik Frangu pati një jetë të vështirë, që i kaloi në burg dhe në punë të rënda, i ndarë dhe i veçuar nga të gjithë, edhe për dasmë e për mort, i deklaruar armik i klasës, thënë shqip ai i përkiste asaj klase që duhej përndjekur dhe shfrytëzuar.

Tofiku mbijetoi, por mori shumë plagë ngajeta, që i kanë ardhur njëra pas tjetrës, edhe atëherë kur nuk e priste kurrë. Por ai, ndonëse i dobët fizikisht dhe në moshë të shtyrë, mbahet i fortë, veçanërisht nga ana shpirtërore. Ai lindi në vitin 1920 në Lis të Matit. Pati një fëmijëri si e të gjithë moshatarëve të tjerë. Shkollën fillore e bëri në Lis,

kurse gjatë viteve 1938-1939 bëri një klasë edhe në Burrel, në ciklin e shtatëvjeçares. Si mbaroi këtë shkollë, në pamundësi për të vazhduar më tej, u mor me punët e bujqësisë në shtëpi të vet, në fshatin Lis. Xhaxhai i tij Jakupi (Çupi), njeri i ndershëm dhe i drejtë, me përvojë jetësore, ishte këshill i fshatit dhe pyetëj dhe nderohej nga të gjithë. Ku kishte ndonjë padrejtësi, shkonte Çupi dhe e ndante punën dhe njerëzit pajtoheshin. Midis tyre nuk hynte hasmëria. Dalëngadalë, veçanërisht me kalimin e moshës, Çup Frangu u bë sinonim i së mirës, i paqes dhe i drejtësisë. Edhe kur filloi Lëvizja Nacionalçirimitare, Çupi po detyrën e këshilltarit bëri në fshat dhe më gjerë, pasi drejtuesit e lëvizjes, që ishin vendas, e njihnin autoritetin dhe ndikimin e tij. Tofiku një pjesë të madhe të kohës e kalonte pas Çupit dhe ishte nën ndikimin e tij. Nëpërmjet Çupit, partizanët i çuan fjalë të bashkohej me ta dhe të kontribuonte për çirimin e atdheut. Tofiku, edhe pse i besonte Çupit, por edhe pse mendonte se pas çirimit do të ishin zgjedhjet e lira, që do të vendosnin për formën e regjimit, doli në mal partizan. Për këtë ai ka edhe dëshminë e Veteranit të Luftës Nacionalçirimitare.

Tofiku shërbeu si nënoficer në vitin 1945, duke punuar si financier në komanda të ndryshme, si në Tiranë, në Korçë, Peshkopi, Mat, Zerqan, Shkodër etj. Ishte i ndershëm dhe i përkushtuar në punë, korrekt dhe i

sjellshëm, gjëzonte respektin dhe dashurinë e të gjithëve. Ishte 19 vjeç dhe mendonte për t'u arsimuar dhe për t'u bërë dikush në jetë. Por më 23.11.1948 e arrestuan. Në dëshminë e penalitetit thuhet se mbi Tofik Frangun rëndonin katër akuza: “për pjesëmarrje në grupin antipushtet”, “për kryerjen e veprës së spiunazhit”, “për ndihmën që ka dhënë në djegien e lidhjes kulturore” (Me Bashkimin Sovjetik), dhe “për agitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”. Për të gjitha këto dënohet me 20 vjet burg. Me dekret të presidentit nr.1582, datë 04.12.1952, falet.

- Sot e them me sinqeritet, se do të kisha dëshirë t'i kisha bërë ato pér të cilat u akuzova, por e vërteta është se nuk bëra asgjë, - kujton ato vite Tofik Frangu dhe vazhdon:

- Ajo godina që paskam dashtë unë me djegë, edhe sot e kësaj dite është pér bukuri. Por në atë kohë, po të futën në burg, nuk dilje pa u dënuar, se ndryshe do të dukej se gabon partia dhe organet e saj. Më në fund, pas disa muajve në hetuesi, më nxorrën në gjyq. Na kanë gjykuar në kinemanë “Partizani” me megafonë dhe zhurma të tjera që populli ta merrte vesh se me çfarë armiqsh të trezikshëm kishte të bante, njëri prej të cilëve isha unë, një djalë i ri nga Mati që nuk kisha bërë asnjë të keqe. Me 1952 më liruan. Shkaqet e lirimit tim kanë qenë dy: e para, isha shumë i sëmurë. Isha i prekun nga sëmundja e tuberkulozit, , “e veremit”, siç i

thonin atëherë, që aso kohe ishte vdekjeprurëse si Sida dhe kanceri sot, se nuk kishte ilaçe për ta shëruar. Ndejta më shumë në infermierinë e burgut dhe në spital. U dobësova dhe u drobita aq shumë sa kushdo që më shikonte, bindej se nuk e kisha të gjatë. Shkurt, më nxorën nga burgu që të vdisja në shtëpi. Për lirimin ka ndikuar edhe nëna ime e ndjerë që nuk la gur pa lëvizur, si thonë, për të më nxjerrë prej andej. Ndikim kanë pasë edhe Haxhi Lleshi e Et'hem Barhani. Nuk kam pse të mos e them, bile u jam mirënjoħes! Si shkova në Lis, në klimën dhe në ajrin e pastér, u përmirësova dhe u ktheva nga rruga e vdekjes. U martova dhe më lindën shtatë fëmijë, njëri prej të cilëve nuk jeton më dhe ky është Kujtimi, djali im më i madh, përvjetorin e të cilit nuk e lëmë pa kujtuar. Djali i dytë imi është Shkëlqimi, i cili, në vitet e demokracisë bëri shkollën për jurist dhe sot është avokat në Thumanë. Djali tjetër, Bajrami, kreu fakultetin ekonomik dhe punon në Tiranë si inspektor tatimesh. Djali tjetër Jakupi, dhe ai me fakultet ekonomik, është emigrant në Itali. Astriti është mësues në shkollën tetëvjeçare të Lisit. Njëra prej vajzave Kimetja, është martuar në Thumanë, kurse tjetra, Pemja, në Mamurras”.

KUJTIM FRANGU

Kujtim Frangu, djali i madh i Tofik Frangut, lindi me 1955 në katundin Lis të Matit. Ishte inteligjent, me një ndjeshmëri të lartë shpirtërore, i bënte përshtypje gjithçka. Tek ai la mbresa të veçanta fakti se ishte i biri i një të burgosuri politik. Kjo gjë atëherë kishte një kuptim të veçantë: ishe i dënuar për një faj që s'e kishe bërë, disa breza me radhë. Prej një të burgosuri politik nuk e pësonin vetëm djemtë, por edhe djemtë e djemve e më tej. Gjithkush që i ka jetuar ato vite, e di mirë se biografia e gjyshërve ishte një gjë e rëndë, pale më e babait, e vëllait apo e personave të tjera të afërt. Kujtimi qysh në moshë fare të njomë e kuptonte që ishte i privuar nga arsimi i lartë, madje edhe nga arsimi i mesëm. Kishte damkën e të deklasuarit, që ishte si ajo damka që u vë rojtari i pyllit drurëve që janë caktuar për t'u prerë. Natyrave poetike dhe inteligjente, si ishte edhe Kujtimi, u bëjnë shumë përshtypje padrejtësitë, ato shkarkesa të padukshme faji

që nuk merren vesh nga e kanë origjinën, por që e mpleksin jetën e njeriut dhe e qarkojnë me një rrjetë merimange.

Kujtimi mbasë edhe për këtë arsyen pati një pjekuri të parakohshme. Kjo dukej në sjelljen e tij, në veprimet dhe gjykimet. Shkollën fillore e nisi dhe e kreua në Lis. Ishte nxënës shumë i mirë, merrte gjithnjë notën më të lartë. Vetëdija se nuk do të mund të arsimohej, nuk ia fashiti kurrë dashurinë për dije. Ata që kanë qenë mësues në kohën e diktaturës, e dinë mirë se nxënës mjaft inteligjentë, meqë u përkisnin familjeve “të deklasuara”, meqë ishin pa shpresë, mësonin sa për të kaluar klasën. Kujtimi ishte një përjashtim edhe në këtë drejtim. Ai nuk e kishte konceptin se mësohet për dijeni. Ai kishte thjesht ndijimin se nuk mund të bënte ndryshe, se nuk mund të mos mësonte. Kujtimi bënte një përgatitje serioze dhe përgjigjej me qetësi dhe qartësi, me një fjalor të pasur dhe me një gjuhë të pastër letrare, në dallim nga shumë nxënës të tjera që përdornin një gjuhë “tmerrësisht” dialektore. Mësuesit, falë atdhetarizmit të përgjithshëm të tyre, falë atij humanizmi që ta jep edhe profesioni, nuk ia ulën kurrë notat pse ishtë fëmijë i një të deklasuar. Ata madje e lavdëronin Kujtimin para gjithë nxënësve të tjera, e merrnin shembull atë. Mësuesit e donin dhe e vlerësonin lart Kujtimin, por ata nuk mund ta shkilnin “vijën e partisë”, duke i dhënë atij diçka më shumë se nota që meritonte. Ndonëse Kujtimi

ishte një recitues i shkëlqyer, kur bëhej ndonjë koncert i vogël në shkollë me këngë dhe recitime para “udhëheqjes së partisë”, ai nuk kishte vend në grupin artistik, sepse partia djalit të armikut të klasës nuk ia donte as këngën, as vallen, asgjë...

Kjo luftë e egër klasash ishte e shtrirë horizontalisht dhe vertikalisht. Ajo ishte gjithëpërfshtirëse. Nuk ushtrohej vetëm ndaj Kujtimit, por ndaj të gjithë atyre që kishin ndonjë “kleçkë” në biografi. Mënyra se si sillej partia, veçanërisht ajo në bazë, me inteligjencën ishte shumë fyeze dhe, njëkohësisht, shumë injorante. Mësuesi i vjetër Q.N. thotë “Kur botøhej ndonjë artikull me “rëndësi” në “Zërin e Popullit”, prej atyre artikujve të gjatë që thuhej nën zë, me ca pëshpërima misterioze, se i shkruante vetë “shoku Enver”, na mblidhnin me urgjencë në sallën e këshillit pedagogjik, duke ndërpërë edhe mësimin dhe duke shkurtuar orët. Me një solemnitet të veçantë artikullin fillonte ta lexonte sekretarja e organizatës – bazë të partisë së shkollës, një mësuese fillorreje, që në të vërtetë bënte “nec – nec”, se s’dinte as të lexonte. Kur lodhej, ia kalonte gazeten komunistes tjetër. Pas organizatës – bazë, “Zërin e Popullit” në mënyrë kolektive mund ta lexonte edhe mësuesja që na bënte formën e edukimit. Askush tjetër, se quhej “herezi”. Po mësuesit e kuptionin këtë mënyrë sjelljeje, kurse nxënësit jo kurdoherë... Kujtimi ishte nga ata që e

kuptonte. Ai e kishte provuar diskriminimin që i bëhej për shkak të biografisë. Ishte nxënësi më i shkëlqyer i klasës, por nuk mund të zgjidhej për “mbrëmjen qendrore”, ku udhëheqësit lokalë të partisë kalonin disa orë me pionierët e dalluar në prag të Vtit të Ri. Kishte ndonjë nxënës që, ndonëse nuk ishte i shkëlqyer si Kujtimi, qante dhe përplaste këmbët përse nuk e zgjidhnin, kurse Kujtimi jo! Absolutisht jo! Ai vetëm tërhiqej mënjanë dhe meditonte me atë mënyrën e vet duke i parë gjërat me një gjakftohtësi, pa qenë i zoti për t'ua ndryshuar rrjedhën. Ishte nxënës në klasën e tetë të shkollës tetëvjeçare të Lisit, kur u shkoi një ekip kontrolli nga seksioni i arsimit. Njërit prej inspektorëve i bëri shumë përshtypje përgjigja e shkëlqyer e Kujtim Frangut në mësim. Inspektori duke mos e përmbajtur entuziazmin që buron nga kënaqësia që ta jep një rast si ai, i tha: “Bravo, Kujtim Frangu. Kur të mbarosh shkollën e lartë, ti do të bëhesh një profesionist i shkelqyer në fushën tënde!”. Po drejtori i shkollës, që ishte edhe sekretar i organizatës së partisë, iu afroa tek veshi dhe, në formë vërejtjeje, i tha: “Këto punët e kuadrove këtu i dimë ne dhe jo ju atje lart... E shkele fare me ato që i the Kujtim Frangut, pasi ai është djali i një të burgosuri politik, armiku i klasës dhe partia nuk do të bëjë këta më shkollë të lartë që pastaj të na e futin ujët nën rrugoz”. Inspektori nuk pati kurajon ta kundërshtonte me ndonjë farë mënyre injorantin

e fanatikun, se, po ta bënte këtë, i shkonte “pusulla” prapa, para se ai të mbërrinte vetë në qytet...

Megjithëse Kujtimi mbaroi me rezultate të shkëlqyera shkollën tétëvjeçare, nuk i dhanë të drejtë studimi për ndonjë shkollë tjetër. As që mendohej një gjë e tillë. Të gjithë ata që i kanë jetuar ato vite, veçanërisht në zonat rurale, ku lufta e klasave bëhej më e egër edhe për shkak të injorancës, e dinë mirë se sa nxënës të shkëlqyer ngelnin pa shkuar në shkolla vetëm e vetëm për çështje biogrtafie. Sa specialistë të zotët ka humbur Shqipëria vetëm për këtë arsy. Sa kokëtrashë kanë zënë vendet e të shkëlqyerve vetëm e vetëm pse ishin “tanët”, me biografi të mirë. “Ju në njëfarë mënyre i kundërvihë partisë, kur u vini nota të mira fëmijëve të familjeve të deklasuara, - u tha një sekretar i byrosë së partisë në një kooperative bujqësore arsimtarëve të fshatit dhe shtoi. – Ju, me këtë veprim që bëni, sikur doni të thoni se partia bën padrejtësira, se kështu duket vërtet në pamjen e parë, por partia vështron larg, larg, aq sa vështrimi juaj nuk shkon dot. Po t’i japësh të drejtë studimi dhe të bësh me arsim të lartë djalin ose vajzën e një familjeje të deklasuar, ata nesër, pasnesër, kur t’u vijë për mbarë, e kthejnë “timonin” nga kapitalizmi dhe iu kundërvihen sukseseve të mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat e jetës”.

Kujtimi “u hipi këmbëve” dhe u nis për në Burrel për

të ndjekur shkollën e mesme të përgjithëshme, katër orë vajtje dhe ardhje, në palcë të dimrit dhe në zhegun e vapës. Asnjë ditë nuk mungoi, asnjëherë nuk shkoi vonë dhe i papërgatitur. Mësuesi T.T. tregon: “Vinte shpesh i lagur nga këmbët deri në kokë. I thoja të dilte tek soba për t'u tharë. Po ai nuk dëgjonte, qëndronte aty, në fund të bangave, me sytë pishë tek ora e mësimit. Se ku e gjente atë forcë ai djalosh i ri, as sot nuk jam në gjendje ta shpejgoj. “Tek Kujtim Frangu vërtetohej ajo thënia e famshme se një shpirt i fortë mban në “këmbë” një trup të dobët, dhe një shpirt i dobët, shkatërron edhe trupin më të fortë. Tek Kujtimi forca shpirtërore ishte shumë e madhe.

Kujtim Frangu mbaroi me rezultate të shkëlqyera shkollën e mesme të përgjithëshme. Për shkollë të lartë nuk bëri as përpjekjen më të vogël, e dinte që do t'i thonin: “Të Kujtim e di se bir i kujt je, ke pasë babën në burg dhe, në bazë të kritereve që ka vendosur partia, nuk mund të shkosh në shkollë. Kushdo të të japë të drejtë studimi ty, nuk ta jep organizata bazë”. Vërtet vërtetimi nga organizata bazë e partisë të fshatit, lagjes, qendrës së punës etj., kishte një rëndësi të jashtëzakonshme, vendimtare. Pa atë nuk vlenin as notat e shkëlqyera, as gjuhët e huaja që mund të dije, asnjë lloj tjeter zotësie dhe kualifikimi. Ishte vlerësimi sipas kritereve politike. Prandaj Kujtim Frangu u kthye

prapë në fshat dhe filloi punën në kooperativën bujqësore. Brigadieri e futi në brigadë. Brigadierët, zakonisht njerëz pa shkollë, ose me disa klasë të marra me "shkelma", si thonë, në përgjithësi kanë pasë një kompleks inferioriteti ndaj të shkolluarve, veçanërisht ndaj djemve inteligjentë si Kujtim Frangu. Brigadierët ishin themeli i piramidës së diktaturës, parë kjo nga lartësia e majës së saj. Në këtë kuptim edhe ata ishin të shtypur dhe të shfrytëzuar, por, nga shpirtvogëlsia dhe injoranca, kënaqeshin që kishin të tjerë, "nën vete", prandaj dhe nuk kishin pse të bënин dallime midis tyre. Njerëz si Kujtim Frangu i caktonin në punët më të rënda që t'ua ulnin personalitetin dhe dinjitetin. Por, edhe sikur të donin t'u bënien ndonjë trajtim të diferencuar, nuk i linin të tjerët. Prandaj ata, brigadierët, kishin merak ta zhvillonin vetë luftën e klasave dhe shumë syresh u kanë shkaktuar dhimbje të tjerëve. Psikologjia e brigadierllékut nuk është mundur edhe sot. Kur njërit prej ish-brigadierëve iu tha se atëherë, në diktaturë, kishte fukarallëk ekstrem, kishte varfëri absolute, sa gjithë brigada, në rrrezet e diellit, ulej dhe hante një copë bukë të kalbur me një qepë dhe, në rastin më të mirë, me pak gjizë, ai u përgjigj: "More, pa bukë, do të rri veç të kem mundësi ta vë edhe njëherë brigadën në tresht, në urdhërat e mia, si dikur". Ishte vetë sistemi që prodhonte nga një "klonim" i veçantë, monstra të tillë.

Në të vërtetë, të paktën për një periudhë kohe, Kujtim Frangu kishte një brigadier të mirë, i cili përpinqej t'ia “mbante krahun”, si thuhet, por nuk arrinte të bënte ndonjë gjë të madhe, pasi drejtuesit e kooperativës filluan t'ia “mbledhin rripat”. Metoda për të kontrolluar njëri-tjetrin, për të mos besuar te njëri-tjetri, për të raportuar haptas ose fshehtas njëri-tjetrin, ja cila ishte ajo që i mbante nën tutelë të gjithë. Ky monstruozitet njerëzor trajtohej si luftë kundër indiferentizmit, çka nuk ishte gjë tjeter veçse shkatërrimi i personalitetit të njeriut, zhdukja e kufijve midis jetës private dhe asaj të kopesë njerëzore. Të gjithë ishin kundër të gjithëve, asnjë nuk mbetej jashtë kontrollit dhe i pandëshkuar.

Për këtë arsyе Kujtim Frangut nuk mund t'i sillte dobi brigadieri zemërmirë, i cili, ndoshta, në mënyrë intuitive, i kuptonte padrejtësitë e mëdha të sistemit, që u imponoheshin atyre poshtë nga ata që ishin lart, megjithëse nuk rreshtnin duke thënë se “nga burimi ujët del i kulluar, por ai turbullohet rrugës”, me çka i lihej fajt prapë popullit.

Në këto rrethana, Kujtim Frangu u pajtua me fatin, por me një kuptim filozofik, jo të kryeunjësisë, jo të nënshtimit, jo të përqafimit të filozofisë shtypëse, por, përkundrazi, të ngritjes së një barriere shpirtërore midis saj dhe vetes, që të mbijetonte dhe, në të njëjtën kohë, të ngelej i pastër, i papërlyer, i paprishur. Tashmë ai qe

martuar me Fitneten nga Dukagjini i Matit, me të cilën Zoti i fail katër fëmijë, tre djem dhe një vajzë: Aleksandrin që sot është në Angli, Durimin, emigrant në Greqi, Kladin, nxënës në shkollën e mesme të Lisit, dhe Sabien, nxënëse në shkollën tetëvjeçare. Kujtimi, i bëre me katër fëmijë, e kishte më të madhe ndjenjën e përgjegjësisë. I donte shumë fëmijët dhe përpiqej t'i edukonte si duhej, por nuk kishte kushte ekonomike për t'ua plotësuar nevojat materiale. Asnjëherë nuk i kënaqi dot me rroba të reja, me ushqim të bollshëm dhe me cilësi. Punonte shumë, por paguhej pak, me ditë pune.

Kujtimi bëri një kërkësë për të punuar si traktorist, në fillim si ndihmës, pastaj do të drejtonte traktorin. Nuk ishte punë e lehtë e për t'u pasur zili se natë-ditë arave dhe ugareve do të rrinte, gjithnjë midis pisllëkut dhe pluhurit. Megjithë këtë, në fundin e pesëmbëdhjetëditshit merrje pagën për t'ua çuar fëmijëve. E bëri kërkësen se nuk shikonte ndonjë arsyé për të mos ia pranuar, se, në punë të tillë, me hekura dhe me graso, kishte edhe shumë njerëz me biografi më të keqe. Fundja, ishte ai që kujdesej për autokombanjat, motorkorrëset dhe për të gjitha makineritë e brigadës. Madje edhe me traktor, të cilin dinte mirë taniste, kishte punuar natën, kur nuk e shikonin të tjerët.

Ngaqë dinte, e caktonin punëtor plugu...

Po sekretari i byrosë në kooperativë i tha: "Kujtim,

kërkesën tënde për traktorist e morëm, e shqyrtaum me vëmendje dhe vendosëm të mos e pranojmë. Ka një arsy që partia e mori këtë vendim. Ai që sot drejton traktorin, nesër do të drejtojë tankun në luftë. Po a je ti Kujtim Frangu i përshtatshëm për të të dhënë në dorë një mjet luftarak kaq mizor siç është tanku? Me ndërgjegje duhet të përgjigjesh edhe vetë se nuk je, se, fundja, edhe pse ti nuk je fajtor, i përket asaj klase që nuk na e do të mirën dhe pret rastin si gjarpëri për të na kafshuar. E pra, djalit të një të dënuari politik ne nuk mund t'i japim tankun në luftë se, në vend që të sulmojë armikun, sulmon ne.”

Kujtimi e dëgjon i qetë, në sytë e tij dukej një dritë e lehtë ironie që sikur thoshte: “Pa, pa sa e zgjuar është kjo partia...”

Po sekretari i byrosë sikur ia lexoi mendimet dhe shtoi:

“Ti pale si mendon, por, si djalë i zgjuar që je, e kupton që partia don t'i ruajë njerëzit e vet nga të deklasuarit, tek të cilët, përfat të keq, bën pjesë edhe ti. Po të flas hapur, me sinqueritet, ndryshe do të të thoja me hipokrizi, siç thuhet shpesh: partia të ka të vetin, ti përpiku dhe puno, se partia do ta ketë parasysh punën tënde e të tjera dokrra... Jo, jo, Kujtim! Janë të ndara gjërat njëherë dhe përgjithmonë. Partia përgatitet për situatat më të vështira dhe të jesh i bindur se përgatitjet e saja nuk do të shkojnë

kot”.

Por partia kishte edhe raste kur tregohej “zemërgjerë”, kishte raste që dhe ajo “mbyllte njërin sy dhe njërin vesh”. Tofik Frangu kujton:

“Kisha edhe gjashtë muaj për të dalë në pension, por e lashë punën se nuk kisha takat të punoja. Por edhe pensioni duhej... Punoja në ndërmarrjen e shfrytëzimit të pyjeve... Kam punuar shumë vjet aty... I thashë përgjegjësit të sektorit: “A ka mundësi të bije djalin, Kujtimin, në vendin tim, se ti e shikon që unë nuk kam mundësi të punoj më?”

“Punëtor defenitiv nuk e marrim, - m'u përgjigj ai. – Në vend tënd le të vijë të punojë. Kur të të mbushen ty muajt e pensionit, i japim udhën edhe atij.”

Dhe Kujtimi shkoi për të punuar në pyje. E ndjeu veten më mirë aty.

Puna nuk ishte e lehtë, madje më e rëndë se në kooperativë, por njerëzit më ndryshtë: më zemërgjerë, më fisnikë, më të hapur dhe më të sinqertë, pa ato “ngucangucet” e kooperativës. Pylli sikur të bën më të pasur në shpirt. Kujtimit i pëlqenin shumë pyjet. Verë-dimër aty kishte një bukuri të veçantë, magjepse. Në dimër pylli sikur rënkonte nga pesha e dëborës; oshëtima e tij ishte e mistershme dhe madhështore, ajo ndihej larg, larg dhe ti provoje një ndjenjë sikur pylli ishte një qenie e gjallë...

Këtë ndijim Kujtimi e provonte kur pylli sakatosej nga vjedhësit dhe hajdutët e pamëshirshëm, që e prisnin drurin, një bojë burri lart tokës dhe trungjet e mbetur duke shin si kokalla kafshësh prehistorike që kanë mbetur në ca luftime legjendare... Në verë ato fashat e dritës, duke shin si shpata të zjarrta që prisnin drurët.

Por, si u mbushën gjashtë muajt e pensionit të Tofikut, Kujtimin e larguan nga puna. Ishte hera e parë që kjo gjë nuk bëhej me dëshirë nga ata që e drejtonin!

LUFTA E KLASAVE NË LIS

Për të kuptuar më mirë se në çfarë mjedisi politik dhe shoqëror u trrit dhe u burrërua Kujtim Frangu, është e nevojshme të japim disa kujtime që na kanë ardhur, nga dy ish-mësues që kanë punuar në vite të ndryshme në fshatin Lis. Megjithëse ata vetë nuk kanë qenë objekt i luftës së klasave, prapë se prapë është ndjerë prej tyre trysnia e kësaj lufte, e cila mbi Kujtim Frangun dhe familjen e tij është ushtruar me tërë ashpërsinë.

Kujtimet e para vijnë nga z.Fehmi Kaloshi që ka qenë mësues në Lis në vitin shkollor 1958-1959, kur lufta e klasave ende nuk ishte në kulmin e vet, kur ajo nuk i kishte ato format e stërholluara që i mori më vonë. Këto kujtime nuk lidhen me Kujtim Frangun dhe familjen e tij, por kanë vlerë se shërbejnë si “dekor” i ngjarjeve të mëvonshme. Në këtë kuptim, ato e kanë vendin e vet në këtë libër.

Kujtimet e tjera, që u përkasin viteve 1974-1975, vijnë prej arsimtarëve Petrit dhe Tamara Pernaska, që jo vetëm

kanë qenë me punë në Lis, por edhe kanë banuar në shtëpinë e Kujtim Frangut. Për vlerat dhe autenticitetin që kanë, po i japim pothuaj të plota, duke hequr vetëm ndonjë pjesë që nuk i shton ndonjë gjë këtij libri. Redaktimi i tyre do të jetë i karakterit gjuhësor, duke vënë dorë vetëm në renditjen e kryeradhëve, dialogeve, për t'i paraqitur si një prozë kujtimore që të lexohet me endje. Personat realë që kritikohen nga autorët e kujtimeve, do t'u vihen vetëm inicialet, pasi qëllimi i këtij libri është shhangia e pakënaqësive, sado të vogla të jenë ato.

“Kam qenë mësues në Lis në vitin shkollor 1958-1959, - thotë Fehmi Kaloshi. - Jepja lëndët e matematikës dhe të fizikës. Të them të drejtën nuk pata ndonjë pasojë nga lufta e klasave në Lis, kjo edhe përfaktin se qëndrova pak kohë, nga dhjetori i vitit 1958 deri në qershori të vitit 1959. Arsyja tjetër lidhet me atë që babai im, Selim Sulë Kaloshi i Sinjës, kishte miq në Lis; ne kishim marrë tek Kadjet gruan e Emin Kaloshit, vëllait tim.

Drejtë shkolle në shtatëvjeçaren e Lisit ishte z.Bashkim Frangu. Mësues ishim pak, se shkolla ishte e vogël. Përveç meje në atë shkollë ishin edhe disa mësues të tjera: Kristina Gera, nga Shkodra, e bija e Rrok Gerës, jepte gjuhën shqipe; Sadik Zeneli, nga Vinjolli, jepte shkencat. Ishin edhe dy arsimtarë në fillorë: Halim Dulla

dhe Halit Ruçi. Të paktën këta më kujtohen.

Këshilli i fshatit ne mësuesve jabanxhinj na caktoi të jetonim në shtëpinë e Isuf Selmanit në Lis. I biri i tij, Qemal Selmani, me vëllain, Halilin, na priten me dashuri dhe ngrohtësi si të ishim të familjes. Ishte një shtëpi e madhe, me tetë dhoma. Mua më kishin dhënë një dhomë më vete, Kristina me të atin, Rrokun, kishin dhomën tjetër. Rrok Gera kishte qenë i burgosur politik. Në Lis erdhi tek e bija, pasi kreu dënimin në burgun e Burelit. Kishte mbaruar jashtë shtetit për ekonomist. Në qeverinë e Zogut për një farë kohë kishte qenë ministër i financave. Ishte burrë me kulturë, zotëronte disa gjuhë të huaja. Gjermanishten dhe italishten i dinte edhe e bija, Kristina.

Prezencën e luftës së klasave e shikoja tek qëndrimi i z. Rrok Gera, i cili dilte nga shtëpia vetëm dhjetë minuta në mëngjes dhe dhjetë minuta në mbrëmje, duke qëndruar para derës së shtëpisë, sa për të marrë pak ajër të pastër. Pjesën tjetër të kohës e kalonte brenda në dhomë. Këtë nuk e bënte nga dëshira, por nuk kishte rrugë tjetër për të mos shkuar prapë në burgun e Burrelit.

Një rast tjetër, që më ka lënë mbresa: Tafë Kadiut i vdiq e ëma. Tafa ishte familje e prekur politikisht, i cilësuar “armik” dhe “kulak”. Fshatarët, edhe pse ia kishin borxh në bazë të traditave dhe të normave kanunore, për shkak të luftës së klasave, nuk shkuan për t’ia bërë varrin e nënës.

Tri herë shkoi Tafa tek këshilli i fshatit për një gjë të tillë. Këshilli urdhëronte herë njërin dhe herë tjetrin, por fshatarët nuk bindeshin. Më në fund, kryetari i këshillit thirri katër prej tyre dhe u dha besë e garanci se nuk do të kishin asnjë pasojë prej një veprimi të tillë, prandaj të shkonin për të bërë varrin e plakës. Ata kësaj here u bindën.

Nga Lisi ruaj kujtimet më të mira nga populli dhe nga nxënësit që kam mësuar, një pjesë jo e vogël e tyre kanë qenë të shkëlqyer. Po kujtoj vetëm disa, si: Rakip Tafaj nga Burgajeti, Ali Zeneli nga Vinjolli, Fatmira Koçi nga Burgajeti, Feride Abdiu nga Burgajeti, Allaman Kadiu dhe Rifat e Sehit Kadiu nga Lisi etj.

Nga viti 1959 deri në vitin 1964 isha mësues në Gur të Bardhë ku jepja matematikë dhe fizikë në shkollën shtatëvjeçare. Në Gur të Bardhë lufta e klasave ishte më e butë. Kjo mbasë ka ndodhur për faktin se gurabardhasit japid dhe marrin, pra bëjnë miqësi, brendapërbrenda fshatit. Kishin të gjithë lidhje gjaku me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, Guri i Bardhë ka pasë një hapje më të madhe me trevat e tjera, pasi ishte rrugëkalimi, nyje e rëndësishme ku “gërshetoheshin” shumë rrugë”.

“Dola nga zyra e seksionit të arsimit, zbrita kodrën, kalova përmes qershive dhe arrita tek ura, - thotë në kujtimet e tij Petrit Pernaska. – Aty kishte disa njerëz. Më

ra në sy një grua e moshuar, e shkurtër, që pinte cigare. E pyeta sa larg ishte fshati Lis. Nuk më tha sa larg ishte fshati. Më pyeti se ku do të shkoja në Lis. I thashë se isha emëruar mësues aty.

- Hajde, me faqe të bardhë, - më tha.

Pastaj u kthyte nga kodra dhe thirri:

- O Kujtim, o Kujtim! Hajde këtu!

- Çfarë do, oj Bije?

- Unë jam korrierja e Lisit, - më tha ajo jo pa krenari.

Ndërkohë, djaloshi Kujtim qe kthyer.

- Kujtim, shkon bashkë me mësuesin e ri në Lis. Të mësojë rrugën e shkurtër se do t'i duhet.

E falenderova korrieren Bije dhe u nisa me Kujtimin. Ky ishte takimi i parë me Kujtim Frangun. Ku ta dija unë sejeta më kishte përgatitur të papritura të tjera?! Nisem rrugën për në Lis. E mora me mend që ishte lizdan. E pyeta si e quanin.

- Kujtim Frangu, - më tha.

I thashë se quhesha Petrit Pernaska dhe se isha emëruar mësues i gjuhës e i leximit letrar në shkollën 8-vjeçare “Haxhi Zhguni” të Lisit.

Duke u ngjitur shpatit të kodrës, biseda gjarpëronte si rruga këmbësore. Kur po kalonim përmes dushkajës, ashtu të djersitur, mes korit të gjinkallave, Kujtimi më tha që mund të uleshim për pak pushim. E kuptova që e bënte

për mua.

- Mirë, - i thashë. – Ulemi.

Nxora paketën “Partizani” dhe ia zgjata.

Buzëqeshi si vajzë e turpshme dhe më tha:

- Faleminderit, s’ë djeg.

U lumturova që nuk e pinte. Eshtë fiksimi imi që nuk dua që ta pinë të tjerët.

- Mos e pi kurrë, - i thashë.

- Kështu them, - u përgjigj.

- Me se merresh? – e pyeta, se nuk dija a shkonte në shkollë, apo punonte në kooperativë. Më dukej më i rritur se një djalë i tetëvjeçares.

Me atë buzëqeshjen e tij të ëmbël më tha se ishte nxënës në gjimnazin e Burrelit, banonte në Lis, e bënte çdo ditë këtë rrugë, dhe e donte shumë shkollen. Më imponoi respekt. E vlerësova, së pari për arsimdashjen e tij. Ndërkohë, e kisha mbaruar cigaren. E hodha në tokë bishtin e saj. E shtypa me këmbë. Më pa me bisht të syrit dhe buzëqeshi. I bëra një pyetje befasuese:

- Pse buzëqesh?

- Dukesh që je djalë qyteti, por sikur je rritur në fshat.

Rrugës ecje si ne, me hap të gjatë, fike cigaren me këmbë, si ne.

E pyeta për jetën në fshat, kooperativën. Përgjigjet ishin paksa krenare për fshatin, jetën. Ndërkohë, i ishim

afruar Lisit. E pyeta për antenën që dukej majë një bregu.

- Eshtë ripetitori, - më tha. – Aty afër e kam shtëpinë.

Kaluam rrugës që gjarpëronte përmes disa shtëpive e dolëm në një shesh, ku dukej qendra e Lisit.

- Ajo është shkolla, - më tha. – Xhadeja të çon tek vatra e kulturës, te klubit. Aty besoj se do të gjesh drejtorin dhe kryetarin e këshillit. Më fal që nuk të shoqëroj dot, por kam punë dhe po shkoj në shtëpi.

U skuq paksa dhe uli kokën i turpëruar. Më zgjati dorën duke më thënë: - Punë të mbarë. Jemi fshat arsimdashës. Shkolla e parë shqipe në Mat, është hapur në Lis nga një jabanxhi, Abdurrahman Përmeti. Do ta kalosh mirë në Lis. Mirë u pafshim!

E falenderova dhe u ndamë. Dola në xhade. Rrugës po mendoja: “Përse nuk më ftoi në shtëpi?”

Arrita tek qendra. Shkova tek shkolla. Ajo ishte e mbyllur. U ktheva tek klubit. Në banak ishte një burrë i imët. Porosita një kafe dhe një gotë ujë. Sytë e të gjithëve ishin drejtuar tek unë. Banakieri solli gotën e ujit dhe kafen. Kureshtja nuk e la pa më pyetur:

- Nga të kemi, or mik?

- Jam nga Tiranë, jam emëruar mësues këtu. Dëshiroja të takoja drejtorin ose kryetarin e këshillit.

Pas pak erdhi një burrë i shkurtër, energjik, fytyrë rrumbullakët, me flokë onde, të prera shkurt dhe të ngritura

lart. Përshëndeti me dorë “Tungjatjeta!”

- Tjeta, Sele, - iu përgjigjën.

E mora me mend se ishte drejtori i shkollës.

Kur u ngrita për t'u larguar, e pyeta drejtorin se kur duhej të paraqitesha në punë. Ai më tha:

- Me datën 20 gusht të jesh në Lis. U ndava me ta duke u thënë: “Mirë u gjetsha!” Më thanë të gjithë: “Mirë ardhsh!”

Ky ishte prezantimi i parë me punën si arsimtar. M'u duk pak i ftohtë, sikur unë isha i detyruar t'u nënshtrohesha atyre, drejtuesve. Ky mendim ishte dhe mbeti i vërtetë për “kuadrot” dhe i gabuar për njerëzit e popullit të Lisit, që i kujtoj me respekt dhe mirënjohje të thellë.

Me datën 19 gusht 1974 u nisa për në Mat. Arrita në Burrel. Në seksionin e arsimit u paraqita në orën 9.00. Ishin mbledhur shumë njerëz. Shefi i arsimit, Esat Sula, na futi në sallën e mbledhjes. Takimi ishte i shkurtër. Unë, Ilia Qiqi dhe Arjana Bejo ishim caktuar në Lis. Arjana nuk ishte në sallë. Dolëm. Ilia me humbi nga sytë. Më vonë mora vesh se ishte me shokët që kishin ardhur nga Gjirokastra. Dola tek agjencia. Hipa në karrocerinë e një makine që shkonte për Balgjaj. Zbrita tek pazari në Lis. Shoferi mori dhjetëlekshet. Shkova tek shkolla. Takova drejtorin. Ai i ra telefonit dhe kërroi Xhemal Sulën. Nuk vonoi shumë dhe erdhi. Nuk kishin gjetur dhomë. Xhemali kishte fjetur

gjumë. Më në fund nuk e mora vesh se si na caktuan në shtëpinë e Dan Milkurtit. Atë nuk e kishin lajmëruar. Dolëm të pinim një kafe. Tek furra e bukës u përballa me Kujtim Frangun. Ky, sa më pa, uli kokën e nxitoi hapat duke shtrënguar bukët nën sqetulla. Shtanga. Pse bëri sikur nuk më pa? As unë nuk arrita ta përshëndes. Erdhi një makinë. Nga ajo zbriti Ilia, ashtu i qeshur, sportiv, energjik. Ia prezantova drejtorit, kryetarit. Shkuam në mensën e kooperativës dhe hëngrëm drekë: kos dhe makarona. Më në fund erdhën dy makina. Fati ynë: kishte vende bosh. Arritëm në Burrel. Zumë hotel. Të nesërmen arritëm në orën 7.00 në Lis.

Hymë në klub. Filluan të vijnë arsimtarët. I pari hyri Fadil Frangu. Erdhi na dha dorën dhe tha:

- Mirë se ardhki. Punë të mbarë!
- E pyeta si e kishte mbiemrin. “Frangu” më tha.
- Ç’ë ke Kujtim Frangun?

Më pa me një shikim zhbirues me ata sytë e zinj, pastaj tha:

- Kushëri!

U takuam me mësuesit e tjerë. U vetëprezantuam. Shkuam tek shkolla. Drejtori Sele dhe udhëzimet, ndarjen e lëndëve, klasat etj., gjithçka për fillimin e vitit shkollor. Mua dhe Ilias na tha se do të flnim tek Dan Milkurti.

- Do të vijë t’ju marrë dikush, - shtoi ai.

Hëngrëm drekë prapë tek mensa e kooperativës. Sapo dola nga mensa u përballa me Kujtimin. Kishte marrë bukët. I fola:

- Ç'kemi, Kujtim?
- Mirë, faleminderit!

Pastaj i prezantova edhe Ilia Qiqin. Kujtim Frangu, s'di përse, e përvodhi shikimin dhe, pasi rregulloi bukët, na zgjati dorën.

Shikimi i tij i shqetësuar. Tha:

- Më falni, kam punë, më duhet të ik.

E treta herë që takohesha dhe ndjeja se diçka e mundonte atë.

Shkuam të flinim në shtëpinë e Dan Milkurtit. Ishte një burrë fjalëpakët, i fismë, si i thonë shkurt: burrë zamani. Na priti në dhomën e miqve. Pavarësisht se ishim më të rinj, në trajtoi si moshatarë. Bëri çmos ta ndjenim veten të lirshëm. Bujaria, thjeshtësia, ciltërsia dhe përkujdesja e tij ishin lapidare. Jetuam pak aty, por sikur kaluam një jetë të tërë. Ruaj respekt të thellë dhe mirënjohje për atë burrë.

Meqë ishte larg dhe dimrit ishte rrugë e keqe, kryetari i këshillit, me ndërhyrjen e drejtorit, mendoi të ndryshonim banesë. Na thanë se do të shkonim te Tofik Frangu, pikërisht në shtëpinë e Kujtimit. Tofiku apo kishte rregulluar ngjitur me shtëpinë dy dhoma të reja. Pa i gëzuar vetë, hymë ne.

Familja e Tofik Frangut përbëhej nga gruaja, Behixhja, fëmijët, Kujtimi, Fitnetja (Leta), Shkëlqimi (Cimi), Astriti (Titi), Pemja, Bajrami, Jakupi (Kupi), të gjithë të vegjël, asnje nuk punonte në kooperativë, ishin në shkollë në Lis dhe në Burrel. Jeta ishte e vështirë, por vështirësinë e përballonin me krenari, dinjitet, punë. Ishte një familje si zgjua bletësh, çdonjëri prej tyre kishte një detyrë të caktuar, që kryhej me përpikmëri të madhe. Me stoicizëm të jashtëzakonshëm Tofiku (Lala), si e thërrisinin fëmijët, i drejtonte ata në punët e shumta, që ka një familje në fshat. Lalës në atë kohë i kishte ardhur në krah Kujtimi, që i ngjante shumë në karakter, por ishte më i përmbajtur, veti që ishte kultivuar që fëmijë në shtëpinë e Tofik Frangut. Nga pëshpëritjet në “telefon pa tel”, si thonë në Lis, morën vesh se ai ishte i dënuar politik si armik, madje i përmendor edhe në veprat e Enverit, dhe shikohej si një leproz, të gjithë ushmangeshin bisedave me të, por dhe Tofiku dhe fëmijët ushqeshin sa të mundeshin. Kjo damkë kishte sjellë vetëpërmbajtjen e tyre. Shikonin të përballonin të gjitha punët, madje në mënyrë shembulllore, si në kooperativë, shkollë dhe kudo. Kjo ishte ngulitur aq shumë, sa tek Kujtimi ishte bërë pjesë e karakterit.

Ilia, si më i ri që ishte, të paktën katër vjet më i vogël se unë, luante futboll me djemtë e lagjes. Kjo u ra në sy lizdanëve dhe filluan të gjykonin në mënyra të ndryshme.

Tofiku mundohej të frenonte Kujtimin, duke i thënë se po linte pas dore punët dhe mësimet. Po i riu si veriu. Ilia përgjigjej:

- Mos u mërzit, xha Tofik, se nuk pengohemi për mësimet. Ja, një orë luajmë.

Dhe me të vërtetë aq vazhdonte loja. Ku e dinim ne se kishte sy zhbirues.?

Në buzë të shtëpisë kalonte kanali ujitës i kooperativës dhe mes oborrit dhe kanalit ishte një pjesë shtufi me pjerrësi nga kanali, që nuk i ishte matur si tokë are Tofikut. Ky me fëmijët e mbathën me pleh e me dhë, pastaj mbollën pemë. Dhe sot ajo pjesë është bahçja e sakrificës dhe gjelbërimi i vetëm i oborrit shtuf të shtëpisë. Kujtimi me vëllezërit dhe motrat e ktheyen në një brezare të mrekullueshme. Nisja e Kujtimit për në shkollë ishte si një orë “Omega” për ne që të ngriheshim. Kur kthehej Kujtimi nga Burreli, ne kishim ngrënë drekë. Ai hante bukë shpejt e shpejt e fillonte punët: ushqente bagëtinë, i nxirrte buzë kanalit të mbajtur me litar, mblidhje bar, gjethë pemësh, bënte mullarë etj. Tani e mora vesh përsë Kujtimi me shmangej në takimet publike. Më ruante prej “kosës” së luftës së klasave.

Jetuan për një kohë të shkurtër tek familja e Tofikut. Vdekja aksidentale e Ilias, që e shpallën “Hero i Punës Socialiste”, ishte një goditje e rëndë për mua, familjen Frangu dhe nxitje e sulm për shikimet zhbiruese. Në

kortezhin që u organizua nga komiteti i partisë, komiteti ekzekutiv i rrethit të Matit, unë këmbëngula që Pemja, vajza e Tofikut, të vinte me ne në fshatin Jergucat, meqë na kishte shërbyer si motër e vogël, duke na pastruar dhomën, duke sjellë ujë nga burimet, pavarësisht se e kishim edhe nxënëse. Tofiku kundërshtoi jo se ishte fanatik, po se e dinte që nuk do ta lejonin nga ana politike. Këmbëngula. Të nesërmen, kur do të niseshim për Gjirokastër, Pemen nuk e pranuan. Lotët e pafajshëm në sytë e saj fëminorë dhe dënesa e saj, më revoltuan shumë si mësues dhe si njeri. Sekretari i partisë e të tjerë, më thanë prerë dhe krenueshëm:

- Atë e di partial

Këmbëngula prapë si mësues dhe nga ana njerëzore.

- Ti edukon brezin e ri dhe luftën e klasave duhet ta zhvillosh pa qurrvitje. Je komisar i kuq, mos harro!

Thënë më troç: "Mbylle gojën"! Pasojat ishin më vonë.

Kur u kthyem nga Gjirokastra, unë i kërkova falje Tofikut për goditjen që i dhashë pa dashje. E kujtoj edhe sot e kësaj ditë revoltimin e tij. I kisha hequr plagës koren. Kujtimi , si i vetëpërbajtur, ndërhyri dhe tha:

- Lalë, mësuesi donte të na shpërbiente, por ai nuk e njeh armiqësinë e heshtur në Lis. Nuk ka faj mësuesi.

Vendin e Ilias e zëvendësoi Stefani, mësues. Meqë Stefani ishte i vëllai i Heroit të Punës Socialiste, nuk mund të qëndronte në familjen e armikut të popullit, Tofik

Frangut, prandaj e caktuan në familjen Cuka, bashkë me mua. Filloi lufta e ashpër e klasave.

Me ardhjen e gruas së Stefanit në Lis, Sofisë, dhe mbesës së saj, unë duhet të largohesha dhe përsëri më çuan tek Tofiku. (Komisarin e kuq tek armiku i partisë dhe i popullit!) Atë që kishin pështyrë, po e lëpinin. Këtu filluan odisetë pér mua, Kujtimin e familjen Frangu.

...Kujtimi vazhdonte shkollën e mesme. Kërkonte ndihmë pér t'u qartësuar pér letërsinë. Lexonte shumë. Kishin Balzakun. “Iluzionet e humbura” e lexi me një frymë. Më befasoi me konkluzionin: “Dëgjo, mësues Petrit! Unë nuk kam iluzione, nuk kam çfarë humbas. Jeta më ka treguar medaljen më të keqe”.

U shtanga, u çorodita. Nuk fola, zgurdullova sytë. Buzëqeshi si zakonisht, por triumfator.

- Unë e di, vetëm shkollën e mesme do të bëj, prandaj mësoj, mësoj shumë që të mos më shkelin. Kujdes, shmangiu grushtit të jetës!

Në fillim e mora si konkluzion të përvojës së tij jetësore. Më vonë e kuptova se paralajmërimi i tij lidhej me pjekurinë e Kujtimit para kohe. Pas pak duke diskutuar, më thotë:

- Këndej nga ne thonë: “Djalë i mirë në Burgajet, ja motmot ja dy vet”. Dhe kishte të drejtë. Thashethemet bënin punën e tyre.

Ndërkohë, u ndërrua drejtori i shkollës. Ishte Faik Vuka dhe më vonë H.S. Në provimet e lirimit këmbëngula për një nxënëse. E quanin Esma. Ajo ishte absolute. Në provimin me gojë u përgjigj shkëlqyeshëm. I them: “Shumë mirë”. Ik, vlerësohesh me notën dhjetë”. Këtu filloi herezia. U grisën disa procesverbale. Nuk mund të firmosja përveç se dhjetë për Esmanë. Panë ç’panë, fitova unë. Fitova si njeri, por dyshimet filluan.

Në vitin 1976 erdhi gruaja ime, Tamara, anëtare e partisë. Emërohet nëndrejtoreshë, pavarësisht se H. ishte me kurs partie, dhe Tamara kishte mbaruar universitetin e Tiranës. Lufta kishte filluar. Kujtimi në këtë kohë më thotë: “Po rrezikon shumë. Ty të lumtë që mbron të drejtën, por mund ta pësosh. Mos i bjer murit me kokë. Sot muri nuk luan, burri po.”

Prapë u befasova nga maturia dhe pjekuria e Kujtimit.

Pavarësisht se Tamara ishte anëtare e partisë, nëndrejtoreshë, ne vazhdonim të qëndronim në shtëpinë e Tofikut. Ishim si një familje, shkonim dhe vinim. Isha i detyruar të hyja tek kulla e tij edhe për nevojat vetjake, në banjo. Shto pastaj edhe për të kërkuar pak kripë ose ujë. Për hir të së vërtetës, kishim marrë edhe disa gjëra që nuk mund t’i sillnim nga Tirana. Hynim dhe dilnim si njerëz.

Ndërkohë, tek kafja thureshin intrigat. Sytë zbirues – fundërrina të çdo lloj shoqërie, vazhdonin... Me

paturpësinë më të madhe mblidhet organizata e partisë dhe mendojnë ta “kryqëzojnë” Tamarën, anëtaren e partisë, për zbutje të luftës së klasave. Dhe kush? Ata... fëlliqësirat e shoqërisë, imoralet, dembelet, pijanecet e të paaftët. Tamara, nga “e kryqëzuar”, i kryqëzoi në atë mbledhje. Debat i ishte i ashpër.

Kur ajo erdhi në mbrëmje, Tofiku i tha:

- Të kam thënë, mos më fol në mexhelis: “xha Tofik, si ia çove?”. Unë dua që prej meje të mos u hyjë një gjemb në këmbë.

Kujtimi, që tash rrinte i menduar, qetë-qetë, me zë pak të nervozuar, tha:

- Duhet të kesh kujdes, po mos u frikëso. Mos u jep shkas. Ata e dinë se sa herë hyn dhe troket në derën tonë. Ju kanë sjellë këtu që t'ju godasin si ne. Ju nuk sajuat të qena e të paqena (për ne), prandaj ju sulmojnë.

Ndërkojë, shkolla e vjetër ishte bosh, se u ndërtua shkolla e re. Problemi shkoi në komitetin e partisë. U gjet zgjidhje e veçantë. Në mjediset e shkollës duhej të përshtasja një banesë. Në këtë punë pata të bëja me kulakun e Lisit, babanë e Esmaë, Nazifin. Punonim bashkë. E respektoja dhe më respektonte. Për mua punonte më tepër se ç'duhej.

...

Transferimi në fshatin Baz. Pavarësisht nga shkëputja, ne vazhdonim të mbanim lidhje. Takoheshim si miq dhe vëllezër e motra. Edhe pas transferimit për në Tiranë, vazhdonim lidhjet dhe vazhdojmë akoma... Vitet kaluan...

Vjen një ditë Bajrami dhe më thotë:

- Fadili marton djalin, nxënësin tënd, Fatosin.
- Kur bëhet dasma, se u kam thënë Fadilit dhe Ferides që do të vijmë. Më tha datën. Dhe shtoi: "Do të vij të të marr dhe do të shkojmë bashkë".

Në datën e caktuar erdhi dhe më mori. U nisëm për në Burrel familjarisht: Unë, Tamara, dy vajzat, Alketa (Izdnia) dhe Erinda.

Pa arritur në Lis, afér kodrës së repeditorit, Bajrami më thotë:

- Lala dhe Behixhja nuk janë në Lis. Janë në Fushë Krujë, se Astritit i ka vdekur goca.

Shtangëm.

- Përse nuk më the, ne andej kaluam, kishim ndalur, kishim bërë ngushëllimin dhe pastaj niseshim.
- Kështu më tha Lala, - më ndërpren Bajrami.
Ndërkohë iu afroam shtëpisë. Lehu qeni. Unë thirra:
 - O i zoti i shtëpisë, a pret miq?
 - Hajde, bujrëm, miq paçim, - u përgjigj Kujtimi dhe

me një fryshtë doli krahapur duke u përqafuar me ne me mall dhe dashuri.

Hymë brenda, s'e zinte vendi. I shtroi të gjitha më zemër, buzëgaz. Pyeste, vetëm pyeste. Pas njëfarë kohë, tha:

- Tek dhoma jote është...
- Po, - i thashë dhe shkuam atje. Na priste domixhani. Pimë pak dhe u nisëm për në dasmë të Fadilit. Dasma si dasma. Kujtuam kohët e shkuara. S'do mend edhe politika në mes. Mbeta i habitur kur mora vesh se disa bastardë të shoqërisë së kaluar kishin dalë po aq të zellshëm tanë si demokratë. Po më vinin zorrët në gojë. Rrjeta i heshtur...

Thënë troç, sahanlëpirësit kanë ndërruar zotëri.

Kujtimi që po shërbente në atë kohë, i vuri kapak floriri bisedës.

- E shkuara e harruara, - tha. – Të gjithë kemi vuajtur, jemi vëllezër dhe nuk kemi gjë për të ndarë. I tillë ishte sistemi. Hajd, gëzuar për çiftin e ri.

Dasma u ndez prapë.

Të nesërmen në mëngjes dolëm të shikonim se si kishte ndryshuarjeta në Lis. Kur shkuam tek shtëpia e re që kishte ngritur, Kujtimi më thotë:

- Edhe ti si Lala, nuk dini të falni. Ajo kohë ishte atëherë. Sot ka ndryshuar. Duhet të falim ne që të pendohen të tjerët. Jemi të lirë nga shpirti dhe mendimet.

- I fitove iluzionet e humbura, - i thashë.

Qeshi dhe me seriozitet të theksuar, tha:

- Me çmim të madh. Nuk jam i kënaqur. Humba fëmijërinë e rrininë. Fitova vetëm dinjitetin. E di çfarë i kam thënë Lalës?

- Jo, nuk e di, - i thashë.

- I kam thënë kështu: “Diktatura e pati një të mirë për ty dhe prandaj mos u qaj: fëmiëjt t'u bënë të hajërit”.

Ky qe takimi i fundit me Kujtimin”.

FAMILJA, MIQ E SHOKË PËR KUJTIM FRANGUN

E donte puna të shkoja në Lis të Matit, të shikoja shtëpinë ku ka lindur dhe jetuar Kujtim Frangu, të shikoja shkollën ku ka punuar, vendin ku është vrarë dhe, më në fund, edhe varrin ku prehet i qetë. Rasti m'u dha me 6 maj, Ditën e Shën Gjergjit, një festë me origjinë kristiane, por që në Mat festohet më shumë nga myslimanët. Atë ditë binte një shi i imët si i situr në sitë të mëndafshët. Retë ishin ulur fare poshtë dhe qelli sikur të shtypte. Tutje, nga Balgjaj, endeshin mjegulla të bardha, që merrnin forma nga më fantazmagoriket nga era e lehtë e pranverës. Kafen e mëngjesit e kisha lënë ta pijà me kryeredaktorin e gazetës së Matit, z.Hamdi Hysuka. U takuam para sheshit të bashkisë. Kur mori vesh se ku dhe përse do të shkoja, më tha:

- Kujtimin e kam njojur. Ka qenë një djali shembullor, një demokrat i vërtetë, që i rriddhe mjalt nga

goja.

- Nuk di a do të ketë makina për në Lis, - i thashë Hamdiut.

- Ka sa të duash, se lizdanët që janë në qytet, madje kudo që të janë, Shën Gjergjin e festojnë në vendin e lindjes.

Po nuk kishte qenë gjë për t'u shqetësuar, se, ndërsa bisedoja me Hamdiun, u shfaq Tofik Frangu bashkë me të birin, Astritin, që kishin ardhur të më merrnin. Hipëm në një furgon dhe u nisëm. Kaluam lumin e Matit dhe, si lamë në të djathtë rrugën që të çon në Peshkopi, morëm nga e majta, drejt veriut, duke udhëtuar nëpër fshatrat që shtrihen në krahun e djathtë të rrjedhës së lumit. Udhëtuam njëzet kilometra, në fillim nëpër Shoshaj, pastaj nëpër Zenisht. Janë fshatra shumë të bukur, me toka krejt të rrafshita dhe shumë pjellore, por që nuk janë punuar dhe nuk janë mbjellur me asgjë, për shkak të tarifave shumë të larta të mjeteve të mekanizuara, por edhe për shkak se ata që mund të punojnë, të rinjtë, janë në emigracion. Vijnë e shkojnë, por tek toka nuk afrohen. Si lemë prapa Zenishtin, morëm kthesën nga e djathta, drejt lindjes për në Burgajet. Kam pasur një dëshirë të hershme për të parë “sarajet e Zogollëve”, siç u thonë matjanët. Aty sot nuk ka asgjë. Tofiku më shpjegon se dikur ka pasë plot rrapa të mëdhenj, shumëshekullorë, puse për ujë të pijshëm dhe për vaditje, ka pasë shtëpi të bucura, që i dogji serbi me 1920-tën.

Ahmet Zogu, kur u bë Mbret i Shqiptarëve, deshi t'i ngrejë prapë: u sollën edhe gurët e kuq, të gdhendur me mjeshtëri, që kanë qenë deri vonë. Rrethanat historike nuk e lanë Zogun ta kryente ata detyrë. Kooperativa i përdori ata gurë për të ndërtuar stallat. Vendi është një rrafshnaltë nga e cila duket Mati si në pëllëmbë të dorës. Një vend i denjë për një familje mbretërore. Po sidoqoftë atje nuk ka më shtëpi. A duhet të kishte? Sigurisht që duhej.

Lisi të krijon më shumë fushëpamje se sa Burgajeti. Eshtë fshat i madh dhe i hapur, kryeqendra e komunës, të cilës i ka dhënë edhe emrin. Komuna përbëhet nga fshatrat Vinjoll, Lisi, Gjallish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj dhe Mallunxe, me 5614 fryshtës dhe 1354 familje. Këto janë të dhënat e vitit 2003, se mendohet se popullsia është mjaft më e vogël, për shkak të largimeve të njëpasnjëshme.

Lisi ka toka të buta dhe mjaft pjellore. Nga lindja kufizohet me Qafë Murrën, nga jugu me Kurdarinë, nga perëndimi me Shoshaj dhe nga veriu me Shlliun. Shtëpitë janë të grumbulluara sipas lagjeve. Lizdanët e duan fshatin e tyre, por janë të detyruar të largohen nga kushtet e jetesës, veçanërisht për mungesë të ujtit për vadirje, pasi toka, dhe pse e mirë, nuk prodhon gjë pa ujë.

Edhe familja e Tofik Frangut është “shpérndarë” anë kënd Shqipërisë dhe jashtë shtetit. Po kulla e të parëve është aty. Ajo na pret me bujari dhe respekt të madh. Në oborr

del e para nëna e Kujtimit, Behixhja, nusja e Kujtimit, Fitnetja, motrat e Kujtimit, Kimetja dhe Pemja. Brenda në konak gjetëm Rexhep Barcin, më vonë erdhi edhe Bashkim Marqeshi etj. U shtrua dreka me të gjitha të mirat.

Vetvetiu biseda u vërtit rrëth Kujtim Frangut, që mungonte në atë festë të Shën Gjergjit dhe do të mungojë në të gjitha festat e tjera... Para së të shkoja në kullën e Tofik Frangut, vizitova varrin e Kujtimit që ndodhet në një kodër të bleruar, jo shumë larg shtëpisë. Shumë më i ri se unë në moshë. Më “vështronte” nga fotografia me atë buzagazin që e kanë të vdekurit e sikur dontë më thoshte diçka...

I pari në atë drekë, me dëshirën për të folur për Kujtim Frangun, e mori fjalën Rexhep Barci, një burrë rrëth të gjashtëdhjetave...

- Unë isha brigadier, - më thotë Rexhepi. – Kujtim Frangu ishte zëvendësi im jozyrtar, njeriu tek i cili kisha besim që, po t'i ngarkoja një detyrë, e bënte! Ishte merakli i madh i punës. Brigada kishte makineri, si: traktora, kombajna, makina korrëse etj. Kujtimi merrej me to, i rregullonte dhe punonte shpesh edhe me traktor. Por tinës, natën, kur traktoristi binte për të fjetur se, po ta merrnin vesh ata të kryesisë së kooperativës, bëhej hataja: “Ti i ke dhënë makineritë të birit të armikut të klasës, njeriut të deklasuar për të cilin nuk ka punë tjetër, veç të hapë kanale.

Me kazmë dhe me lopatë të punojë, ku të jetë puna më e rëndë. Nuk duam të na zbusësh luftën e klasavë, shoku Rexhep. Organizata bazë e partisë dhe kryesia të nderuan, të ngritën në përgjegjësi dhe të bënë brigadier. T'ia dish për nder partisë dhe të jesh vigjilent për ta mbrojtur atë nga armiqtë që një herë duan të fusin në dorë traktorin, pastaj autokombajnën, pastaj tankun dhe, më në fund, veç kur t'i shohësh që na e kanë futur ujet nën hasër". Ja, kështu flisnin e thonin ata për Kujtimin. Më vroftë kjo bukë, që po hamë, nëse e ke një fjalë trene nga unë. Një herë shkuam bashkë me Kujtimin për të mbyllur liqenin e Balgajit, që shërbente si rezervuar i madh për ujitje. Unë mora Kujtimin, se tek ai kisha besim se e bënte punën si duhet... E morën vesh ata të kryesisë së kooperativës dhe më thirrën në zyrë. Më bënë për ujë të ftohtë:

"Po ç'bën ti, o Rexhep Barci? Po na i bën lëmsh punët në kooperativë! Na merr Kujtim Frangun, djalin e të burgosurit politik dhe ma shpie në digën e liqenit, i beson punë të tilla me zarar! Po përse, mor shoku Rexhep? Kështu ia shpërblen partisë ti? Ne me bukë, dhe ti "bam" me gurë. Po a shkohet me Kujtim Frangun në atë vend strategjik?! Se ja, armiku i klasës nesër shkon pa ty dhe "fap" hap digën dhe veç kur të përmbytet fshati dhe tërë krahina..." Bëra autokritikë, nuk kisha ç'të bëja. Po më polli puna me blektorët, me çobenjtë. Ata donin të kishin Kujtimin, se ai

ia dinte çdo pune. Ua thashë si larg e larg atyre të kryesisë këtë dëshirë të barinjve dhe e “përforcova” kërkesën e tyre me vështirësitet që kishte sektori i blektorisë. Por kur m'u lëshuan, bë ne Zotin bëj, kujtova se qenë duke më ngrënë: “Po ende nuk e ke marrë vesh kush është Kujtim Frangu! Dashke të na e çosh me bagëti që të rrrijë tërë ditën hijeve! Bleji edhe një fyell, se edhe kjo ka mbetur pa e bëre! Dhe merr vesh një herë e mirë: Kujtim Frangu nuk duhet të rrrijë qosheve në kooperativë, por aty, në ballë, në baltë, me kazmë, në punën më të rëndë. Dhe aty të mbahet nën vëzhgim, se si thotë ajo fjala e urtë: “Ujët fle, armiku nuk fle”.

- Kujtimi më ka hapë një plagë të madhe në zemër, që nuk ka me m'u shnoshë kurrë, - thotë nëna e Kujtimit.
- Ka qenë djalë i mirë, jo pse ishte imi. I urtë, që nuk ja prishi kujt një herë, nuk i tha kujt “plaç” ai njeri! Kujtim këtu, Kujtim aty, e kishim si pushkën e shkurtë, se ishte ma i madhi. I kam rritun me një mijë halle, nuk u qahen të këqijat. Ja, vinte Tofiku, i zoti i shpisë, dhe m'i binte ke puna, me kosha, si të ishin kunguj, dy mënjanë, e dy n'anën tjeter... Nuk kisha ç'tu jepja me ngranë, nuk kisha ç'tu jepja me pi, nuk i kam vesh si duhet, asnjiherë nuk u kam ba qejfin si fmijë që ishin. Për kët' i vjen keq nanës, se s'i pashë një herë të knaqun, një herë të veshun e të mathur, si donte nana, po ashtu, të mërdhizun, tue u ruejtë prej

dexhalave komunistë që jo vetëm Tofikun, por ene fëmijët m'i gjuenin si të kishin ba zollumet e dynjasë! Ja, kështu asht rrit Kujtimi, dro këtu e dro atje, mos me e lanë kërkund rehat. E lanë pa shkollë, pa të gjitha, pa asgja... Kujtimi u rrit me halle e me të këqija. Kur erdh demokracia, thashë se pamë nji ditë të bardhë ene ne, ene Kujtimi, po nuk qe thanë... Bante shkollen në Burrel, djali i nanës, pa bukë shkote, pa bukë vite. S'i asht fre mulla ene me bukë, birit të nanës. Kët qan nana, se shkoj i pa gëzue, i pa rehatue... Vinte e shkonte nji makinë nga Burreli në Lis. Kujtimi ishte në shkollë. Të gjithë i merrte në makinë ai shoferi, Kujtimin jo. Një ditë më thotë: "Moj nanë, ajo makina nuk ka vend për mue..." "Thuhej se je djali i Tofik Frangut, mos të merr ene ty", i thashë. Ç't'i thosha! Po ai shoferi rezil i madh kishte qanë e hise në Zotin nuk kishte pasë. I kishte thanë: "Po a nuk je i biri i Tofik Perëndisë, unë në makinë nuk të marr..."

Ajo pushon një cast dhe sytë i përloten. Gjithkush e kupton këtë përlotje, është dhimbje nëne. Pastaj, kur e merr disi veten, shton:

- Fëmijët e mi s'kanë pasë nanë, ene pse unë jam gjallë ene sot, s'kanë pasë babë, ene pse ky asht gjallë ene sot... Se ky punonte ke drutë, natë-ditë jashtë e larg shpisë, po ene unë nat' e ditë në punë të kooperativës isha. Nuk mund të mungoja nji ditë se për mue bëhej nami,

takoheshin qielli e toka bashkë, se ja, isha anmike e madhe unë, do ta rrzoja qeverinë! Kur shkosha në shpi fëmijët i gjeja tue përkund njeni-tjetrin... Babë e nanë kishin Kujtimin, ai asht marrë me ta! Kur kishte ndonjë gja me da kooperativa, ne nuk na jepnin... U da njiherë do rrush, kush ma pak e kush ma shumë. Mue s'më dhanë asnjë kile me u lag gojën fmijëve.

U grita në mbledhje e u thashë këtë gja. “Ulu më thanë, se me këto fjalë si thue, veç u ban dam cullve”... Kujtimi ishte aty. Prekej shumë, po e mbante veten. Kjo e bante të vuente. Atë ditë duroi sa duroi, u grit ene i tha atij që më foli mue: “Pse m’i the nanës se po u bën dëm fëmijëve? Çfarë u kemi bërë, ç’ë keqe u ka ardhë prej nesh? Veç po punojmë, natë e ditë, asgjë të keqe nuk po bëjmë...”

“Ulu, mor aty, dhe rri urtë; - i tha ma i madhi i asaj maledhjeje. – Duhet ta dish se kush je, pastaj të kërkosh të drejtat e tua e më the të thashë...” Prandaj Kujtimi i nanës rrinte i veçuem, nuk shifte kan në sy e nuk i folte kujt me gojë, se e kishin përjashtu nga gjithçka, se ishte i biri i anmikut... Kujtimi e fmijët e mi kanë ndejtë të veçuem si me pasë zgjeben, sikur të kishin nji smundje ma të randë që merr jetë, sikur të kishin nji smundje ngjitetë që i merr me qafë ene të tjerët... Kështu m’i kanë trembun fëmijët “ysh këtu e ysh aty”, mos me pa ditë kurrë, mos me u kënaq kurrë...

Kujtimi nuk kishte anmiq, bile as ai qe vrau, nuk e ka urrye, se Kujtimi nuk dinte se si asht fjala e keqe... Fol e qesh me të gjithël!"

Nusja e Kujtimit është ende mjaft e re, ndonëse djemtë tashti i janë bërë burra dhe vajza që Kujtimi e la 6 vjeç, është bërë trembëdhjetë. Nusja e Kujtimit është një grua e thjeshtë, e sinqertë dhe shpirt njeriu.

Nusen e Kujtimit nuk e lashë të fliste lirshëm. Nga frika se mos e harroja, atë pyetje që mund ta bëja të fundit dhe me më shumë takt, e bëra të fillimit:

- A të ka rrahu ndonjëherë Kujtimi?

- Jo, për këtë bukë, - tha ajo dhe preku bukën. – Nuk mbaj mend të më ketë prekur për keq me dorë. Kujtimi nuk vinte dorë mbi gruan. Kemi shkuar aq mirë, sa nuk thuhet me gojë. Kujtimi ishte i prerë dhe shumë gjëra nuk i lejonte, por dorë s'kishte.

- Një herë, po, - ndërhyri dhe tha Tofiku. – i ka dhënë një shuplakë djalit të madh, që po luante me një automatik. "Kujtim, bre, i thashë, ti nuk e ke zakon të vesh dorë mbi fëmijët. Pse bane kështu?!" E di se nuk bëra mirë, por kaderrliun e merr plumbi. Me armë nuk duhet me luejtë, or babë, se arma e bën të keqen, kur të duash".

- Me kalamajt nuk merrej, - thotë nusja e Kujtimit. – Unë vetë i bëja gati për çerdhe dhe për shkollë, për gjithçka. Por Kujtimi ndikonte tek ata me një shikim. Me t'pamë

Kujtimin, fëmijët e dinin çfarë duhej të bënин dhe çfarë nuk duhej të bënин. I vinte turp t'i përkëdhelte ndër sy të babës dhe të nënës. Pastaj Kujtimi nuk kishte as kohë për t'u marrë me fëmijët, natë e ditë më punë, në punët më të rënda. Një njeri si Kujtimi mua ma çoi fat Zoti. Po Zoti ma mori të ri, para kohe! Kujtimi punonte shumë, por edhe në punë nuk e linin kurrë të qetë...

- Më kujtohet një rast, - thotë Tofiku dhe vijon: - Kishte ardhur prokurori i rrëthit me nja dy të tjerë, dhe shkuan drejt e te grumbullimi i bimëve mjekësore. Grumbullues ishte A.M. Shikon ky prokurori sa lule kishte dërguar njëri dhe sa tjetri. Dhe ja ku del edhe emri i Kujtim Frangut që kishte dorëzuar dy kuintalë. Prokurori bëhet si i çmendur dhe i drejtohet grumbulluesit:

- Kush të tha që të çosh në mal për të mbledhur bimë medicinale Kujtim Frangun?

- Po ai ka shkuar vetë, nuk e kam çuar unë, shoku prokuror!

- E di se ka shkuar vetë, por ti mos i pranoje ato që ka mbledhur. Po ta bëje ti këtë, ai nuk do të shkonte në mal. Bimët nuk i kemi për armiqëtë e klasës, për njerëz si Kujtim Frangu, por për popullin, për tanët! Lekët që duhej t'i merrte i yni, një njeri i popullit, vete dhe ia jep Kujtim Frangut. Nëse ai do lekë, t'i nxjerrë tjetërkund, në kooperativë, në punët më të rënda...

- Po unë nuk kam ndonjë udhëzim... Si gjithë populli..., - se ç'deshi t'i thoshte A.M.

Prokurori ia preu fjalën me egërsi:

- Ç'udhëzime do ti? Nuk e di që Kujtim Frangu është biri i një të burgosuri politik? E di. A nuk e di ti se çfarë qëndrimi mban partia ndaj këtyre njerëzve? Edhe këtë e di. Atëherë, çfarë udhëzimesh pret ti nga unë dhe nga partia? Apo mos je bërë bythë e brekë me Kujtim Frangun dhe me Tofik Frangun? Fol, se ata që përkrahin armikun dhe i bëjnë lehtësira atij, janë më keq se armiku.

A.M. heshti si të ishte fajtor!

- Fol, fol, - e nxiti Astriti të atin, - si të tha Kujtimi për ndarjen e tokës.

- Po, më kujtohet mirë, - thotë Tofiku. – Unë tokën që kemi këtu në fshat, doja t'ja lija Kujtimit, se ai ishte më i madh dhe ai do të rrinte në fshat. Këta që kanë marrë rrugët, i kanë bërë hesapet vetë. Por Kujtimi më tha: “Or babë, në tokë kanë pjesë të gjithë vëllezërti. Nuk ka këtu “i madhi dhe i vogli”, të gjithë jemi njëlloj, të gjithë të Tofik Frangut jemi. Unë nuk mund të pranoj që vëllezërit të mos kenë pjesë në tokë, prandaj, nëse do të ndahmi, na e ndaj pesë e pesë, si thonë...

- Ne nuk u ndamë, - tha Astriti. – Na ndau puna!

- Megjithëse nuk u ndanë, - thotë Kimetja, - kur ikën dy vëllezërit e tjerë, Bajrami e Shkëlqimi, Kujtimi u shemb

duke qarë. Ka qenë si një ditë zie për ne. Makina kishte ardhur dhe priste jashtë e ngarkuar me plaçka, kurse Kujtimi ishte këtu në këtë dhomë, përqafuar me vëllezërit!

- Kështu është, - thotë Astriti. – Një gjel të priste ose një qingj, Kujtimi do të shkonte në Tiranë dhe në Thumanë t'ua çonte vëllezërve pjesën e vetë.

- Kujtimi ishte djalë i rrallë, e mori fjalën z. Bashkim Marqeshi, mësues biokimie në shkollën e mesme të bashkuar në Lis. – Kam punuar në vitet 1994-1996 me Kujtimin. Ai jepte edukimin fizik. Brenda një kohe fare të shkurtër u bë i dashur dhe i shtrenjtë për të gjithë. Unë jam socialist, me bindje të majta, por e kam për nder të them se Kujtim Frangu ishte demokrat i vërtetë. Ai nuk i gjykonte njerëzit për nga përkatësia partiake, por për ato që bënin dhe vepronin. Kishte marrëdhënie të mira me të gjithë. Ishte njeri i sakrificës. Kujtimi i donte të tjerët më shumë se veten. Unë këtë e kam provuar disa herë. Më 1995 u bë një reformë në arsim. Të paktën kështu u quajt. Dhe tek ne fjala “reformë” kuptohet thjesht si shkurtim vendesh. Të gjitha largimet nga puna janë cilësuar si shprehje e “reformës”. Dikush, pra, do të shkurtohej. Siç e dini, PD atëherë ishte në pushtet dhe Kujtimi ishte nga themeluesit e saj në Mat. Atë nuk e largonin nga arsimi. Po e dini çfarë ndodhi: kur u shënuan emrat e atyre që duhej të largoheshin (dhe emri i Kujtimit nuk ishte midis tyre,)

ai u ngrit dhe tha: "Po qe se duhet dikush të shkurtohet, ky jam unë. Jam më i riu dhe arsimin nuk e kam të plotë".

Kjo ma shtoi mua respektin për Kujtim Frangun. Ai ishte djalë i sinqertë dhe i dashur, dhe këtë nuk e them vetëm unë por të gjithë ata që kanë patur rastin ta njohin, veçanërisht ata që kanë punuar me të. Kujtimi ishte djali më i madh i Tofik Frangut, por dhe më i respektuar midis tyre, pasi zotëronte disa cilësira të larta morale që rrallë njerëz i kanë. Ai kishte edhe cilësira intelektuale, të cilat i fitoi me punë. Po ta kishte jetën e gjatë, ai do të ngrivej shumë nga ana intelektuale, sepse ishte studiues.

Ditën që është vrarë, dy orë para se të ndodhët ngjarja, kam pirë me të kafe në klub dhe gjatë bisedës, i thashë:

- Ç't'u desh, mor Kujtim, që hyre në këtë punën e zgjedhjeve në këtë kohë të trazuar?!. Rrije më mirë mënjanë, se nuk është as koha e as kjo punë për ty. M'u përgjigj:

- PD – ja që është partia ime, dhe që e kam zgjedhur me dëshirë të plotë, tashmë është në rënien. Kjo është e përkohshme, por është rënien. Sot për sot nuk është më nder dhe krenari të jesh anëtar i PD, si dikur. Kështu, të paktën, mendojnë mjaft anëtarë e simpatizantë të PD. Kësaj force politike po i ngarkohen të gjitha sa ndodhën, megjithëse asnjeri nuk do të djegë shtëpinë e vet. Nëse do të më duhej ndonjëherë të largohesha nga PD-ja (gjë që unë nuk kam për ta bërë kurrë), nuk do të zgjidhja kurrë

një rast të tillë, kur ajo, më shumë se kurrë ka nevojë për përkushtimin dhe veprimtarinë time dhe të të gjithë anëtarëve dhe simpatizantëve të saj. Frikacakët dhe ata që ia kanë me hile partisë, që janë bërë anëtarë për interesa të caktuara, le të ikin. Unë jo. Prandaj pranova të jem komisioner në zgjedhje, dhe i kam marrë parasysh të gjitha. Madje, unë në këtë komision nuk jam përfaqësues i PD, por i të djathtës shqiptare, sepse këto parti sot nuk janë në gjendje të sigurojnë edhe komisionerë në zgjedhje.

E admirova për forcën e madhe shpirtërore, për burrërinë dhe trimërinë që po tregonte. Por mbi të gjitha, për besën që e kishte të fortë dhe të pathyeshme.

Bije një heshtje e shkurtër. Secili “ndjell” kujtimet, por i ati, Tofik Frangu, është i “tejngopur” me to.

- Vija në fshat, - thotë Tofiku. – Këtu të bijen në qafë, të zënë rrugët dhe duan të të marrin tokën që e ke trashëguar brez mbas brezi. Po Kujtimi nuk donte të bënte shamatë me njeri. Më thoshte: “Shko, or babë, dhe rri rehat atje, në kryeqytet, se këto punët këtu i shikoj unë. Nuk kam ngelur për ndihmën tënde”.

- Kujtimi ishte edhe njeri me takt të përsosur, - thotë Astriti. – Kur u plagos Jakupi, erdhi dhe na gjeti në bukë.

“Hë, ç’kemi ndonjë të re? – e pyeti baba.

“Hiç, asgjë, të gjithë jemi shëndoshë e mirë”.

“Po eja të hash edhe ti me ne”.

“Kam ngrënë, mbaroni punë ju”.

Po dukej që bukë nuk kishte ngrënë dhe se kishte një hall. Ishte prishur në fytyrë dhe mbahej me zor.

- More ti, as bukë nuk ke ngrënë dhe as punët nuk i kemi mirë. Na paska gjetur një e keqe, e shikoj unë, - tha baba.

Po Kujtimi nguli këmbë duke thënë se asnë e keqe nuk na kishte gjetur. Si hëngrëm bukë dhe si kaloi pak kohë, na tha:

“Jakupi është plagosë në këmbë, por mos u shqetësoni, se tashti është mirë”.

Pastaj tregoi ngjarjen: Jakupi me 1997 ishte me forcat e policisë. Kur po udhëtonte me një makinë ushtarake me gjithë shokë, dikush i kishte qëlluar dhe Jakupin e kishte marrë një plumb në këmbë. Mjekët ia hoqën dhe ai pas do kohësh u bë mirë.

- Kur u fejova, - nisi të tregojë e motra e Kujtimit, Kimetja, - u mërzita shumë, pasi do të isha larg shtëpisë, se Lala më dha në fund të dynjasë, si thonë. Kujtimi, kur më pa që po vuaja, më erdhi pranë dhe më tha: “Lumja ti, moj Kimete, që je vajzë dhe, përveç vendit ku ke lindur, ke të drejtë të zgjedhësh edhe një vend tjetër, tek burri që do të marrësh. Ti qahesh pse Lala të dha larg! E ke shumë gabim, Kimete. Kush ikën nga Lisi është me fat, se atje ku do të shkosh, nuk do të të shikojnë si këtu, nuk do të të

thonë: “armikja e klasës”. Lisi është i mallkuar. Të tillë nuk e bëri Zoti, por njerëzit, që nuk kanë as shpirt dhe as zemër”. Kështu më tha Kujtimi dhe mua m'u hoq e keqja, se vërtet atje ku shkova, nuk na morën nëpër gojë dhe nuk na ndiqnin si në Lis. Dhe një gjë dua të kujtoj! Kjo ka të bëjë me ndershmërinë e Kujtimit që nuk e gjen tek ndonjë tjetër. Kur shkonim ne gocat në aksion, të gjitha thonin: “Të vijë Kujtim Frangu me ne, po të vijë ai, nuk kemi nevojë për njeri tjetër”! Vetëm tek Kujtimi kishin besim, se e kishin provuar ndershmërinë e tij. Të gjitha, sa ishin, e donin dhe e trajtonin si vëlla. Kur mblidheshim për të ngrënë drekë, secila ndante pjesën e Kujtimit. Nuk kishte vajzë që nuk e bënte një gjë të tillë. Ai hante bukë bashkë me ne.

Pemja, motra tjetër e Kujtimit, sjell ndërmend një ngjarje të hidhur.

- Kishim do dhi, - thotë Pemja, - ato hynë në një arë të kooperativës. Megjithëse nuk bënë ndonjë dëm të madh, u mblohdh brigada për të na kritikuar, për të na bërë shembull për keq, se kjo ishte një nga ato metodat që përdorin komunistët për të demaskuar “armikun e klasës”. U ngrit një grua që e bëri aq të madh atë dëmin e dhive tona, sa kujtoje se kishin shkretuar Lisin. Unë ia ktheva me do fjalë që nuk ishin shumë të hijshme për një vajzë si unë, të rritur me disiplinë dhe larg fjalës së keqe.

Kujtimi, si mbetëm vetëm, më tha: "Pse, moj Peme, fole ashtu? Të foli, le të flasë sa të dojë. Nga goja e saj ka hije të dalin ato fjalë, bile edhe më të këqija, por jo nga goja jote. Mbaje mend: fjalë vret si plumbi. "Po ne ë nuk nă vrashin çdo ditë me fjalë, a nuk thonë të nëntëdhjete e nëntat për ne?" "Thonë, moj Peme, thonë, se, me këtë biografi që kemi, jemi si arra në rrugë, ku çdo kalimtar e lëshon një gur. Ne vetëm një rrugë kemi: të heshtim dhe të punojmë, të mos u dalim në shteg se, dhe pa u dalë, na kërkojnë vetë". Dhe vërtet na kërkonin. Një ditë po të mungonte Kujtimi në punë të kooperativës, dikush kujtohej dhe thoshte në brigadë: "Po Kujtim Frangun ku e keni? A po lejohet ai të shkojë të mbledhë bimë dhe t'i shesë me pare?" Kaq duhej që të mbledhë kryesia dhe të bëhej nami! Të tjerët nuk i mbante njëri për të mbledhur bimë, por ata nuk e kishin zotësinë e Kujtimit që ngrihej natën dhe ngjitej mal më mal. Ata donin që t'u vinin lulet te dera..."

Kishin kaluar disa orë që bisetonim për Kujtimin. Biseda për të nuk ka të shteruar. Ato më kryesoret sikur u thanë. Por foli Bashkim Marqeshi:

Ka mbetur një dimension i personalitetit të Kujtimit pa u vënë në dukje: besimi që kishte tek Zoti. Kujtimi agjeronët në muajin e Ramazanit. Këtë e bënte me ndërgjegje, dhe jo për të rënë në sy të tjerëve. Unë çuditem se si gjithë ai program kundrafetar deri në ekstrem

në shkollë nuk kishte zënë vend në ndërgjegjen e tij. Them kështu mbasi gjithmonë ai ka besuar. Unë e ngacmoja. Në Ramazan i thosha: “Kujtim, po shkojmë në klub për një gotë raki. Je i ftuar prej meje”. Ai qeshte dhe ma kthente: “Të ma bësh këtë ftesë pas Ramazanit!” Unë, dhe jo vetëm unë, kisha kënaqësi kur rrëtja me Kujtimin, ai të krijonte një ndjenjë komoditeti, me të ndjeheshe mirë. Pak njerëz e kanë këtë veti...”

Hyri në odë një vajzë e bukur dhe e shëndetshme rrëth trembëdhjetë vjeç. Na dha dorën dhe na pyeti për shëndetin si të ishte e madhe, e stërvitur në odat e pritjes të malësorëve. Më thanë se ishte vajza e Kujtimit, Sabia, nxënëse e klasës së shtatë, të cilën babai e la gjashtë vjeç...

Sabia nuk dha ndonjë kujtim për babanë, nuk ia kërkuam një gjë të tillë për hir të moshës, të ruajtjes së disa normave që lidhen me mbledhjen e kujtimeve... Por edhe nga Sabia morëm diçka, madje shumë të bukur. Ajo ndjenjat dhe mendimet për babain e vet i kishte shprehur në një hartim me temë lumturinë njerëzore. Po jap vetëm një pjesë të shkurtër. “Kam qenë më e lumtura në botë, kur rrëtja në prehrin e babit dhe ai më përkëdhelte dhe më fliste për gjëra të ndryshme... Mezi ia kujtoj fytyrën, por zëri i tij, që më dukej si një muzikë e ëmbël, më tingëllon ende në vesh dhe ma ringjall gëzimin e atëhershëm! Zoti ma mori babin në një kohë kur kisha shumë nevojë për

të... Po unë me të çmallem në ëndrra... E shikoj shpesh. Vjen si nga larg, si nga një botë tjeter dhe ma bën me dorë që t'i afrohem... Ka një buzëqeshje si të ngjirë në fytyrë, por mua nuk më duket se ka vdekur... "Afroju, babi, të të përqafoj" i them, por ai buzëqesh, ma bën me dorë dhe ikën diku larg... Unë këto pamje i ruaj deri në mëngjes. Pastaj i lindh ëndërrat me kujtimet dhe portreti i babait dalëngadalë plotësohet..."

- Kujtimi e donte shumë, se e kishim gocë të vetme dhe na lindi mbas tre çunave, - thotë Fitnetja, nusja e Kujtimit. – Vetëm Sabien nuk kishte turp ta përkëdhelte, me atë merrej shumë. Kishte bërë plane për ta çuar në shkollë e shumë gjëra të tjera...

- Sabia është një nxënëse shumë e mirë, - thotë mësues Bashkimi. – Ka një rënie të vogël në mësime, por jam i bindur se do të kthehet prapë ku ka qenë...

Sabia skuqet në fytyrë, por atmosfera është kaq e ngrohtë e miqësore prandaj nuk ndjehet keq...

KUJTIM FRANGU
DHE PROCESET DEMOKRATIKE

Kujtim Frangu i priti me entuziazëm proceset demokratike që nisen në vendin tonë në vitin 1990 e në vazhdim. Ai e dinte se rruga e vetme për ta nxjerrë vëndin nga izolimi total, për ta futur në rrugën e zhvillimit dhe të demokracisë, ishte ndërrimi i sistemit, krijimi i shumë partive që do të konkuronin me njëra-tjetrën me programe dhe projekte të qarta. Lufta politike midis tyre do të ishte e përhershme, duke pasur të përbashkët objektivin mëdhor për të integruar Shqipërinë në Europë, ku ajo e ka pasë përherë vendin e vet.

Kujtim Frangu në proceset demokratike dha kontributin e vet që nuk qe i vogël. Ai u gjallërua si asnjëherë tjetër. Tashmë ishte burri 35 vjeçar, por ndjehej të paktën dhjetë vjet më i ri. Në proceset demokratike nuk u përfshi për motive personale: as për të zënë ndonjë post e për të fituar pushtet e pasuri, as për t'u hakmarrë

ndaj atyre që e kishin lufuar për 30 vjet dhe që ia kishin kufizuar personalitetin. Jo, Kujtim Frangu nuk ishte i tillë. Të gjithë ata që e kanë njohur, të gjithë ata që kanë punuar me të, kanë një mendim të përbashkët: Kujtim Frangu nuk i hynte asnje pune për vete, për përfitim vetjak.

Kujtim Frangu u bë anëtar në Partinë Demokratike qysh në themelin e saj, në partinë më të madhe opozitare, që mori përsipër barrën e rëndë dhe të vështirë për instaluar demokracinë edhe në Shqipëri. Një gjë të tillë ajo nuk mund ta bënte pa pasur në radhët e saj djem heroikë dhe inteligjentë si Kujtim Frangu. Kujtimi, kudo ku të punonte dhe të jetonte, të njëjtën gjë do të bënte: do të militonte në radhët e PD dhe do të kontribuonte përfitoren e saj! Kujtimit i ra të jetonte dhe të punonte në Lis të Matit. Dhe ai këtu u bë luftëtar i shquar për demokraci. Kujtim Frangu iu vu punës me tërë forcat për të ngritur në Lis grupin e PD, bërthamën e sekzionit të PD në këtë zonë të largët, por me tradita atdhetare dhe kulturore. Më në fund, prej punës së tij dhe të shokëve, u ngrit seksioni i PD edhe në Lis të Matit. Gjithkush që i ka jetuar në mënyrë intensive ato vite, e din që një gjë e tillë nuk ishte e lehtë. Mbi njerëzit, vec frikës, që nuk ishte vrarë ende, rëndonte një mal me paragjykime. Por Kujtimi ia arriti. Një ditë u mblodhën të gjashtëmbëdhjetë shokët, anëtarë të PD, për të zgjedhur kryetarin që do t'i udhëhiqte

deri në mandatin tjetër. Zgjedhjet u bënë të lira dhe demokratike. Ishin të parat zgjedhje për të cilat Kujtim Frangu ndjeu një emocion të madh, megjithëse nuk do të votonin mijëra vetë, por vetëm 16. Po nuk ka rëndësi numri i atyre që votojnë. Rëndësi ka që vota të jetë e lirë. Dhe ato vota qenë të lira, u dhanë me vullnet të plotë. Rezultati: 13 votë kishin votuar që Kujtim Frangu të ishte kryetar, tre kishin votuar kundër. Normale, sikur të kishin votuar edhe më shumë kundër. Në të vërtetë kundër kishin votuar vetëm dy, pasi Kujtim Frangu ishte i treti që nuk ia dha votën vetes. Kryetari i atëhershëmë i PD në rrëthim e Matit, z.Shekfi Çupi, tregon: "Seksioni i Lisit u krijua në fillim me 16 anëtarë. U votua për të qenë kryetar Kujtim Frangu, me 13 vota pro dhe tri kundra. Më vonë kam marrë vesh se vetëm dy kishin votuar kundër Kujtimit, i treti ishte ai që votoi kundër vetes. Nuk donte të zgjidhej kryetar. Jo se nuk e donte PD, jo se nuk kishte dëshirë të kontribuonte për të! Jo, ishte tjetër arsy. Ai ishte lodhur dhe kishte punuar më shumë se të gjithë. Ia arriti qëllimit: u themelua seksioni. Nuk donte të thonin shokët se kishte punuar për t'u zgjedhur kryetar. Le ta bënte një tjetër këtë detyrë. Kujtimi do të punonte dhe do të lodhej si më parë. Nuk do të nxitoja të arrija në këtë përfundim, duke u nisur vetëm nga ky rast. Por raste të tjera, të shumta, më kanë bindur se Kujtim Frangu nuk ishte karrierist, ai donte të mirën e

të tjerëve, të mirën e Shqipërisë dhe kjo mund të bëhej edhe pa qenë ai në krye të punëve. Kështu mendonte Kujtimi.

Z. Çupi kujton edhe një rast tjeter:

“Erdhi puna për ta zgjedhur sekretar të komunës së Lisisit. E thirra dhe ia dhashë mendimin tim, bile i thashë se ky nuk ishte vetëm mendimi im, por edhe i kryesisë së PD së Matit.

Po ai m'u përgjigj: “Lisi e ka sekretarin e komunës, i cili është po i PD dhe nuk e ka mbaruar mandatin. Punon mirë dhe nuk ka pse ta zëvendësoj as unë dhe as ndonjë tjeter”. Mbeta pa mend, se tek unë dhe shokët e tjerë të kryesisë vinin përditë demokratë që donin të zinin vende pune, edhe kur nuk kishin as shkollën, as mundësitë për t'i bërë ato punë. Kur ia thashë këtë zotit Afrim Haxhi, ai si u mendua paksa, tha: “Ja, si Kujtimi t'i kemi të gjithë anëtarët e PD. Djem të tillë ka sa të duash, por kush i përzgjedh, se shpesh na zënë këmbët karrieristët dhe të paaftët. Z.Afrim kishte të drejtë: Na rrinin ngjitur para dhe mbrapa, derisa ia arrinin qëllimit. Pastaj, si “ta shalonin kalin”, bënin në kokë të vet, pa pyetur fare partinë. Dhe një fjalë po t'u thoshje, e quanin si ndërhyrje, gjoja “partia na mban nën tutelë” e kështu me radhë. Por Kujtimi ishte gatuar nga një brumë tjeter. Kam edhe një rast për të treguar. Në vitin 1991 u emërua mësues në shkollën

tetëvjeçare të Lisit, se shkollën e mesme e kishte mbaruar me rezultate të larta. Një ditë më foli me një brerje ndërgjegjeje dhe me një si pendesë të thellë që vetëm tek natyra meditative si Kujtim Frangu mund t'i shikosh. “E di si është puna, në atë vëndin tim si mësues do të ishte mirë të punonte vajza e Fadilit... Edhe merr ndonjë lekë, edhe mund t'i dalë një fat i mirë...” Ja, kështu njeriu ishte Kujtim Frangu. Unë solla ca kujtime të një natyre krejt të veçantë për të treguar se ai nuk ishte njeri i interesit, por mendoj se kjo është gjëja më kryesore e një personaliteti, se të gjitha veprimet, të mira dhe të këqija, të poshtra dhe kriminale, në radhë të parë, bëhen përi interes”.
Kujtim Frangul punoi mësues fizkulture në shkollën tetëvjeçare të Lisit nga vitin 1991 deri në vitin 1996. Ishte shembull në veprime dhe qëndrime edhe si mësues. E donin të gjithë: drejtoria, kolegët, nxënësit, prindërit. Ushtrinë e pat bërë gjatë viteve 1975-1977 në një repart pune. Kujtim Frangu nuk duhej të kishte pushkë në dorë, por kazmën dhe lopatën, si gjithmonë. Ai de t'i stërvitej me pushkë druri, por jo më pushkë t'ë vërtetë, luftarakë. Po i miri është i mirë kudo, në çdo vend të punojë, në çfarëdo rrëthanash që të ndodhet. Të mirit prandaj i thonë i mirë, se din t'u bëjë ballë të këqijave! Dhe si Kujtimi nuk kishte njeri tjetër që u bënte ballë atyre. Qëndresën e kishte më shumë të brendshme, shpirtërore. Ai nuk donte një

qëndresë që shkatërronte shpirtin: Po, t'i prishej shpirti, më mirë të vdiste! Edhe në repartin e punës, pavarësisht nga biografia, Kujtimin e donin të gjithë komandanti, komisari, oficerat, por më shumë e donin shokët me të cilët punonte dhe jetonte. Ai të afrohej nga ana e zemrës, e shpirtit dhe prej andej fillonte duke ta ndriçuar horizontin, duke ta falur mirësinë, duke të mbajtur fort që të mbeteshe njeri.

Vëllai i tij, Shkëlqim Frangu, kujton: "Bëmë ca pare dhe familja më vuri detyrë të shkoja të shikoja Kujtimin aty ku ishte ushtar, në repartin e punës, në Elbasan. Shkoya dhe hasa, si është e natyrshme, në postbllok të repartit. U thashë rojave se kush isha dhe kë kërkoja. Bëj be në zotin, iu ndriçua mënjerë ftyra. Thirrën një oficer dhe i thanë ç'kërkoja! Pastaj erdhi vetë komandanti, që më përqafoi me dashuri si të më kishte djalin e yet. Nuk u çudita, pasi e kuptova se ajo dashuri dbe ai respekt i takonin Kujtimit dhe jo mua. Undjeja krenar përvëllain tim! Ishte krenaria e parë që e kam ndjerë, si të thuash; të materializuar aq mirë, të trupëzuar në një formë të prekshme! Komandanti e shprehu edhe me fjalë atë që mendonte për Kujtimin: "Të si vëllai, gjithë familja juaj, gjithë farefisi, gjithë të afermit, duhet të krenohi, me një djale si Kujtim Frangu. Me të duhet të krenohet krejt Lisi dhe Mati."

Pastaj më takuan më Kujtimin dhe më lanë të çmallesha

me të. Prej asaj dite e kam ndjerë peshën e personalitetit të Kujtimit. Kur desha të kthehem në fshat, komandanti më tha: “Kemi therur një kec, se edhe punojmë, edhe hamë. Ti do të jesh në drekë me ne, se je vëllai i Kujtim Frangut. Pas dreke shko nga të duash”. Unë jo, ai po, më mbajti. Kemi kaluar si në një dasmë dhe e gjitha kjo i dedikohet Kujtimit. Kur u ndava prej tij, prej komandantit dhe prej shokëve të Kujtimit, rruga m'u bë e lehtë. Isha bërë me krahë dhe nuk më dukej se ecja, por sikur fluturoja. Doja të mbërrija sa më parë në shtëpi dhe t'i tregoja babës për Kujtimin. Ia thashë të gjitha, pa shtuar dhe pa hequr asgjë. Ai vetëm buzëqeshi pak, si e ka zakon, dhe nuk foli, kurse nëna tha: “Hallall gjinin o Kujtim!”

Vëllai tjetër i Kujtimit, Bajram Frangu, me emocion tregon: “Shkollën e mesme Kujtimi e ka bërë në Burrel. Nuk i thonë shaka, por çdo ditë tri orë në këmbë vajtje-ardhje. Por dashuria për shkollën, dijen dhe kulturën tek Kujtimi ishte më e madhe se sa çdo gjë tjetër. Shkollën në Burrel e ndiqnin edhe disa vajza nga Lisi... Po, si thashë, ishte rrugë e largët, që duhej bërë në këmbë. Sot këtë rrugë e bëjmë për gjysmë ore me furgona, por atëherë ishte rast fatlum të gjeje një herë në muaj një makinë... Vajzat shkuan në atë shkollë dhe e mbaruan atë, vetëm pse ishte Kujtimi. Me atë shoqëroheshin, tek Kujtimi kishin besim ato dhe familjet e tyre. E njihnin se ishte djalë i ndershëm, me

karakter... Kur Kujtimi u bë mësues dhe duhej që ndonjëherë vajzat të shkonin në ekskursion ose diku tjetër larg, shkonin me Kujtimin, pavarësisht se në cilën klasë ishin... Me Kujtimin ishin të sigurtë si me vëllezërit e vet, si me baballarët. Kur është vrarë Kujtimi, nuk kemi qarë vetëm ne familja e tij, të afërmit dhe farefisi, por gjithë lizdanët, kush e ka njohur!"

Kujtim Frangu kishte një dashuri dhe respekt të madh dhe të veçantë për prindërit. Babën dhe nënën i respektonte në kulm, kishte në këtë respekt një adhurim të veshur me një drithë hyjnore. Para tyre ishte i turpshëm si një fëmijë motak. Ndonëse ishte bërë vetë prind, para babës ëhe nënës, kishte mbetur ai Kujtimi i vogël, që zvarritej oborrit duke vrarë gjunjët në gurët e kalldrëmeve..." Kujtimi e pinte duhanin – thotë Bajram Frangu për të. – Por, për një kohë të gjatë e ka pirë tinës babës. I vinte turp ta ndizte në sy të tij. Nuk i kishte qejf gjenjeshtrat, por ishte e vetmja e vërtetë që donte të merrej vesh sa më vonë! ... Kjo lloj sjelljeje sot mund të duket vulgare, disi banale, kur shikon jo djem, por vajza fare të reja, që pine duhen këmbë përmbi këmbë mu në mes të Tiranës... Por të rinjtë e asaj kohe nuk ishin "modernë" si këta të sotmit. Një ditë se nga doli babai papritur dhe Kujtimi futi dorën që mbante cigaren në xhep. Ndejti ashtu disa caste se babai nuk u largu. Prisnim kur të dalë tymi dhe ai doli. Këtë e vuri re edhe

babair Aiqeshi dhe tha: "Or Kujtim, kësaj pune i doli tymi, prandaj mos erdigj xhaketën, pije duhanin hapur!"⁶ Në vitin 1996 Kujtim Franguni e emëruan përgjegjës të administratës në komunën e Losit. Edhe këtë detyrë ai e bëri me përkushtim të madh, me ekzigjencë, me korektesë dhe menjë një sjellje jashtëzakonisht njerëzofën. Ai e dinte që nuk ishte thjesht Kujtimi, por përfaqësues i shtetit. Shteti, sipas tij, duhet prezantuar me kulturë, me dije, me profesionalizëm, duke ia respektuar ligjet, dhe duke mos vepruar asnjëherë në kundërshtim me tò. Tillë ishte vëtëm Kujtimi në komunën e Losit dhe pothuaj në gjithë rrithin. Ishte zyrtar i ri, merrte për herë të parën një detyrë shtetërore, por njerëzve me shpirë delikatë dhel me pasuri ndjenjash si Kujtimi, i cili duhet kurrrafarë përvoste pëntë qenë të ndershëm dhertë përkushtuar. Në korrik 2003, në përvjetorin e gjashtë të rënies së Klujtum Frangut është: "Të gjithë që kemi punuar me Kujtimin, e kemi të vështirë t'i gjemë fjalët e duhura për ishokunë dhe mikun tonë. Ndonëse kanë kaluar 6 vjet, e kujtojmë më respekt dhe krenari shokun dhe mikun tonë itë paharruar".⁷ Në këtë is "Sotëborn" nirdzi kurrë. Një mësues pës Mat, i pyetur përondonjë kujtim për Kujtim Frangun, tha: "Ruajmë në kujtesën tonë qjeriun e mrekullueshëm, që rrallë i gjendet shoku. Po të hapësh këtu

një libër kujtimesh për të, dhe t'i bësh me dije qytetarët për një veprim të tillë, jam i bindur se më shumë se gjysma e tyre, do të shkruajnë fjalët më të ëmbla, do ta shpalosin krejt zemrën për të, se edhe ai zemrën e mbante të hapur në dorë, për çdo njeri”.

Ishim para bashkisë së Burrelit

Kujtim Frangu ndershmërinë dhe thjeshtësinë i kishte tē lindura. Ai nuk mund tē zhvishej prej tyre se do t'i ndodhë si më atë këmishën legjendatë Naususit, që nuk mund ta hiqte, pa shkëputur copëza nga trupi i vet.

RËNIA E KUJTIM FRANGUT

Para se të flitet për zgjedhjet për në Kuvendin Popullor të vitit 1997, zhvilluar me 29 qershor, është e natyrshme të kujtohen rrethanat historike kur u zhvilluan. Kemi parasysh ngjarjet tragjike që ndodhen atë vit. Në këtë libër nuk është vendi as qëllimi për t'i analizuar ato, megjithëse si rrjedhojë e tyre u vra Kujtim Frangu. Këtu është vendi për të theksuar se në vitin 1997 gjendja në Shqipëri ishte e rëndë, kaotike, krejt e pastabilizuar. Nuk kishte gjasa që në ato rrethana të zhvilloheshin zgjedhje të lira dhe demokratike, edhe po të ekzistonte vullneti i mirë politik i të gjitha palëve. Nuk ishin mbushur as tre muaj nga katrahura e madhe dhe asnjë prej plagëve nuk ishte shëruar. Madje vazhdonin të hapeshin plagë të reja. Grupe terroriste bridhnin lirisht me armë në krahë. Ishte e kuptueshme që ato do ta ushtronin trysninë e vet edhe në ato zgjedhje.

Në këtë situatë i ra Kujtim Frangut për short të ishte

komisioner në qendrën e votimit në Lis të Matit. Kujtimi, nga vetë natyra e tij poetike, nga parimësia me të cilën i shikonte problemet, nga urtësia me të cilën donte t'i zgjidhte mosmarrëveshjet, nuk duhej të ishte në përbërjen e atij komisioni ku sundonte “arsyeja” e më të fortit. Z.Shekki Cupi, ish-kryetar i PD aso kohe në rrrethin e Matit, thotë:

- E dinim se Kujtim Frangu nuk ishte i përshtatshëm për ato rrrethana në të cilat zhvilloheshin zgjedhjet, pasi “komunikimi midis të arsyeshmëve ishte ndërprerë” dhe ligjin e bënte forca. Por partitë e djathta, përfaqësues i të cilave qe Kujtimi, nuk ishin në gjendje të përfaqësoheshin me komisionerë, kështu që i ndihmoi PD-ja. Sa iu propozua kjo detyrë, Kujtimi, si gjithmonë, u tregua i gatshëm ta kryente. Ai nuk ishte nga ata që shmanget, pavarësisht nga vështirësitet.

Në Lis në zonën nr.24 nuk u zhvilluan zgjedhjet ditën e caktuar, domethënë me 29 qershor 1997, për mungesë të dokumentacionit të nevojshëm. Raundi i parë i zgjedhjeve në Lis ishte me 6 korrik 1997.

Kujtim Frangu atë ditë ishte në qendrën e votimit, i vendosur për rregull dhe drejtësi. Nuk ishte njeri i lëshimeve të paprincipta dhe i kompromiseve. Po të fitonte kundërshtari, kandidati i palës tjetër, Kujtimi menjëherë do ta njihte rezultatin dhe do të firmoste procesverbalin.

Ai kishte bindjen që rotacioni në pushtet bëhet vetëm me anë të votës së lirë. Atë mbrëmje, kur u numëruan votat, doli që kishte fituar kandidati i të djathtës. U bë procesverbali që u firmos nga të gjithë komisionerët. Kur gjithçka kishte përfunduar dhe ata ishin gati të merrnin dokumentacionin dhe të dilnin nga qendra e votimit, njëri prej këshilltarëve të anës së majtë thotë: “Do të numërojmë edhe një herë votat që kanë dalë të pavlefshme”. Kujtimi e kundërshton: “Ne i numëruam njëherë dhe bashkarisht i nxorëm të pavlefshme, prandaj nuk kemi përse i shikojmë prapë”. Ai e kuptoi se komisionerët e krahut të majtë, përfaqësues të “Aleancës për shtetin”, donin fitoren me çdo kusht. Undez debati një copë herë të mirë, por Kujtim Frangukëmbëngulte në atë që ishte arritur zgjedhjet kishin përfunduar. Atëherë, të undezur nga mëria, të elektrizuar edhe nga turma, ku kishte njerëz të armatosur, njëri nga komisionerët e krahut të majtë i merr dikujt automatikun dhe qëllon për të ngjallur panik. Komisionerët e tjerë ikën nga qendra e votimit. Kujtimi nuk kishte ndërmend ta bënte një gjë të tillë. Ai qëndroi aty dhe po pinte një cigare tek derazku njëri prej plumbave e kapi poshtë supit të djathtë dhe i dolë në ijen e majtë. E çuan në spital me urgjencë. I plagosur rëndë jetoi gati njëzet e katër orë.

I ati, Tofiku, i vajti pranë. Kur e pa ashtu të plagosur që mezi merrte frysë, e kuptoi se djali i tij i madh, krahu i

djathtë, nuk do të jetonte gjatë. Iu desh të përmblidhte gjithë forcat fizike dhe shpirtërore për t'u mbajtur si burrë. "Mendoi: "Kur të bije e keqja, të bije për të bërrë të qash dhe jo të këndosh!" Nuk i kishte shkuar kurrë ndërmend se, pas gjithë atij kalvari vuajtjes, pas ndjekjesh dhe përndjekjesh të pafundme, për pesëdhjetë vjet, t'i ndodhët kjo që ndodhi... "Eh, bre, tha ai me vete, ky Zoti a vetëm me mua e paska pasë..."

"Babë, - i foli Kujtimi me një zë të shuar që sikur vinte nga humnerat më të thella ku vdekja tinzare po priste. – Më kishe më të madhin. U përpoqa të të bëhem krah, se ke vuajtur dhe je munduar shumë, na ke rritur me njëmijë halle... Po të le, babë, amanet fëmijët. E di që po rëndohesh, por mbaju siç je mbajtur përherë se edhe e mira dhe e keqja të vijnë për të të provuar..."

Tofik Frangu shtangu nga ajo që dëgjoi. Kujtimi i tij i dashur nuk e kishte hallin e vetes që po fikej në atë moshë të re, por mendonte për familjen, për babën, për të gjithë.

Tofik Frangut iu kujtua një ngjarje e viteve të shkuara. Kishte kohë që kishte dalë nga burgu. Hyri dhe demokracia. Të gjithë ndjeheshin hareshëm, veçanërisht ata që kishin vuajtur shumë për atë ditë... Gjithë jetën kishte qenë shëndetlig, por tashti nuk ndihej mirë. I tha Kujtimit: "Dëgjo, Kujtim, je djali më i madh dhe po të lë një porosi... Jam i vjetër dhe tek unë vdekja është për së mbari.

“
Të thërrasësh në mortën time të gjitha ata që na kanë dashur, por nuk kanë mundur të na vinin kur ishin në diktaturë, se ashtu ishte koha... Në mortën time nuk dua të qajsh fare, të të mos t'i shikojë njeri sytë të përlotur. Shyqyr që ja mbërrita kësaj dite që ju pashë të gjithëve të lirë, si gjithë shqiptarët. Të ecni nga e mbara, të përpipi të jetoni me punë dhe me djersë të ndershme, si gjithmonë... Morten të ma bësh të mirë. I dua njerëzit aty, tri ditë e tri netë, si dikur... Ai që nuk na vjen edhe këtë radhë, nuk na ka dashur kurrë dhe nuk ka përsë të të mbetet hatri, por, për t'i thurrur, t'ua çosh fjalën në derë të gjithëve”... Kujtimi e dëgjoi sa e dëgjoi, pastaj me një buzëgaz të hidhur, ia preu fjalën e e pyeti:

“Po ç'flet, bre babë kështu?”

“Po hala nuk e paske marrë vesh ç'të thashë?”

“Po, bre babë, e mora, por puna është se unë do të vdesë para teje...”

“Edhe këtë ma the?”

“Po si të të them, babë, unë kam për të vdekur para, në daç besoje, në daç mos e beso... E ndjej këtë...”

Kur pa se Tofiku u mërzit shumë, ai “ndërroi pllakë”, si thonë, dhe i foli me buzë në gaz:

“Bre, babë, desha të të provoj sa trim je, sa e mban të keqen...”

“Jo, Kujtim, o bir, jo, këto nuk janë fjalë për t'u thënë.

Mos më provol! Të keqen tandem mos ma lëshoftë Zoti, se nuk e duroj dot. Të keqen e asnjerit prej fëmijëve nuk e duroj...!

“Mirë, mor babë, mirë, do të thërras të njohur dhe të panjohur, nga Mati e nga Dibra, nga Kurbini e nga Kruja, nga Lezha e nga Tiranë... Kush të ka njohur, këtu do ta kesh, ta japë fjalën... Vdis pa merak për atë punë...”

Me kaq u la ajo bisedë dhe u harrua. Po Tofik Frangut i kujtohej nganjëherë, me të rrallë, dhe ndiente një shije të hidhur në buzë sikur kishte pirë helmin që vinte duke ia ftohur gjymtyrët dhe duke iu ngjitur drejt zemrës...

Dhe ja ... Tani i qëndronte te koka të birit, Kujtimit, që ishte plagosur rëndë dhe dukej që nuk do të shpëtonte. Tashti ishte Kujtimi që po i linte porosi. Dhe jo porosi të mëdha, për vdekje, por porosi jete, për hallet e fëmijëve, se i kishte lënë të vegjël që të katër dhe nuk është e lehtë që fëmijët të rriten pa baba... Tashti ishte Tofik Frangu që mendonte se kush duhej thirrur në këtë mort, në mortin e të birit. Ai kishte pasur shumë shok dhe miq, në të katër anët e vendit... Nuk ishte puna për të thirrur vetëm gjakun e vet, të afërmit.

Ditën tjetër Kujtim Frangun e varrosën. Erdhën shumë, shokët e miqtë e Kujtimit, të gjitha ata që e kishin njohur dhe kishin punuar me të, të gjithë demokratët: nga Kurbini e nga Mirdita, nga Dibra e nga Tiranë, nga Kruja

dhe nga Lezha... Vargu i burrave u bë shumë i madh dhe Tofik Frangu nuk e kishte të lehtë të takohej me të gjithë, t'u fliste një fjalë falenderimi dhe të priste ngushëllimet e tyre... Ishin jashtë, në natyrë. Aq burra nuk do t'i merrnin të gjithë konaqet e Lisit. "Paske pasë shumë miq e shokë, mor i miri i babës", - thoshte shpesh Tofiku me vete, ndërsa priste dhe përcillte. Erdhën në mort edhe përfaqësuesit e PD, përfaqësuesit e partive të djathta, të ish të përndjekurve politikë, folën dhe përshëndetën, ngushëlluan dhe thanë se Kujtim Frangu vetëm fizikisht ka vdekur, por do të jetë pérherë në jetë, më i gjallë se të gjallët, sepse kujtimi i tij, vepra e tij, ajo për të cilën ai dha jetën, nuk do të vdesë kurrë...

Gjëma dhe vajti shkonin valë-valë. Gjëma bëhej në konaqet e grave. Qante nëna, qanin motrat, qanin, veç qanin të gjitha gratë e vajzat lizdane, matjane... Të gjithë ato që e kishin njohur, nuk i mbanin lotët për Kujtim Frangun! Kur po e çonin për në banesën e fundit, gjëma qe e madhe, sa u trand qielli. Pastaj dalëngadalë u fashit se Kujtimi duhej nderuar në heshtje. Ecnin burrat vargan – vargan pas arkivolit ku ishte mbyllur edhe një pjesë e zemrës së secilit. Ecnin burrat në heshtje dhe i mbanin lotët me zor. Atyre që nuk u ishte dridhur qerpiku para betejave, në burgje, ndër tortura, tanj po shembeshin së brendshmi, mbaheshin me zor që të mos zhburroheshin!

PËRKUJTIMORET PËR KUJTIM FRANGUN

Kujtim Frangu, ashtu siç pritej, nuk u harrua. Ai është kujtuar çdo vit dhe do të vijojë të kujtohet edhe në të ardhmen. Nuk është fjala për përkujtimet familjare, ku zakonisht bëhet njëvjetori i vdekjes dhe, fort rrallë, ndonjë përvjetor tjetër. Kaq mund dhe duhet të bëjë familja për njeriun e dashur, kur veprimtaria dhe vdekja e tij nuk kapërcejnë mbi të zakonshmet, kur ato nuk kanë vlerë mbarëshoqërore.

Jeta e Kujtim Frangut dhe vdekja e tij kanë kaluar me kohë “caqet” familjare, të rrëthit miqësor e farefisnor. Për Kujtimin tashmë janë të interesuar shumë njerëz, që nuk kanë lidhje gjaku me të, por lidhej të tjera, që burojnë nga interesa dhe ideale të përbashkëta. Dalja e Kujtim Frangut nga “oazi” familjar ka domethënien e vet. Askush nuk mund të bëhet “i të gjithëve” ose i shumë njerëzve, me urdhër të dikujt, pa e pasur kontributin për të gjithë ose

për një shumicë njerëzish. Një veprimtari mund “të pompohet” dhe mund të ecë disi e shtyrë nga faktorë të tjerë, por gjashtë të tilla, siç janë bërë për Kujtimin dhe që kanë ardhur vetëm nga ngritje, nuk mund të bëhen kurrë pa qenë ngritur lart në shkallë shoqërore, ai të cilit i kushtohen.

Qysh në ditën e varrimit të Kujtim Frangut, pjesëmarrja jashtëfamiljare dhe jashtëmiqësore, që shumë e madhe. Por, meqë ajo ishte një ceremoni mortore, të ardhurit e shumtë dukeshin si një “trumë” disi laramane e pidentifikuar dhe, për atë rast, vetëm me rol ngushëllimi.

Pas një viti, pjesëmarrësit në atë varrim dhe të tjerët që erdhën për herë të parë për të përkujtuar Kujtim Frangun, “u identifikan”; ata nuk ishin dhe nuk kishin qenë as ditën e varrimit njerëz të rastit, të shtyrë vetëm nga një keqardhje njerëzore, që marrin pjesë në një fatkeqësi për ngushëllim dhe aq. Ata në një farë kuptimi e kishin vetë atë fatkeqësi, se ai që ra dhe duhej nderuar, ishte edhe “i tyre”. Këta njerëz ishin të organizuar në parti politike, pjesa më e madhe e të cilëve anëtarë dhe simpatizantë të PD, sepse Kujtim Frangu ishte jo vetëm themelues i seksionit të PD në Lis, por edhe anëtar i kryesisë së kësaj partie në Degën e Matit. Eshtë kjo arsyaja që në varrimin dhe në përkujtimoret e tij, për shkak të vdekjes së veçantë dhe qëllimit për të cilin ra, kanë marrë pjesë disa nga

funksionarët kryesorë të kësaj force politike për gjashtë përvjetore me radhë, si kanë vepruar zotërinjtë Vili Minarolli, Leonard Demi, Ylli Vejsiu, Ridvan Bode, Fatos Beja, Natasha Shehu, Gani Hoxha, Ali Kazazi etj.

Mjaft prej përkujtimoreve janë organizuar nga dega e PD në rrëthin e Matit ku një kontribut kanë dhënë demokratët e këtij rrithi si Kujtim Stana, Shefki Cupi etj.

Përfaqësuesit e PD në ceremonitë përkujtimore kanë sjellë dhe mesazhet e vetë liderit të PD, Prof. Dr. Sali Berisha, i cili, në përvjetorin e tretë të vrasjes së Kujtim Frangut, priti në selinë e kësaj partie familjen Frangu dhe zhvilloi me të një bisedë të pasur në emocione dhe në mesazhe.

Kujtim Frangu nuk u kujtua vetëm në përvjetorin e katërt të rënies dhe kjo nuk ndodhi për “harresë”, por për faktin se ky përvjetor përkoi me zgjedhjet e vitit 2001 për deputetë në Kuvendin Popullor, familja e Kujtimit, rrithi i tij fisnor, ishin përqëndruar në punën e madhe për të arritur fitoren pasi kjo do të ishte përkujtimi më i mirë, konkretizimi i idealit për të cilin ra.

Pas PD Kujtim Frangun e ka “të vetin” edhe një shtresë tjeter e shoqërisë sonë: ish-të përndjekurit politikë të periudhës së diktaturës. Pavarësisht se ishte anëtar i PD, Kujtim Frangu i përkiste një familjeje të përndjekur dhe të persekutuar gjatë gjithë regjimit totalitar, madje në

mënyrën më të egër, duke e izoluar totalisht, duke e lënë pa asnje hapësirë lirie. Ish-të përndekurit politikë jo vetëm kanë qenë pjesëmarrës në përkujtimoret e organizuara nga PD, por kanë organizuar edhe vetë të tilla për Kujtim Frangun, siç qe ajo e gjashtëvjetorit, në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. Drejtuesit dhe përfaqësuesit e kësaj shtrese të shoqërisë zotërinjtë Tomor Aliko, Afrim Haxhi, Besim Ndregjoni, Skënder Qendro, Fehmi Kaloshi etj., nuk kanë munguar në asnje përvjetor të Kujtim Frangut.

Një veçori tjeter e përkujtimoreve të Kujtim Frangut qëndron në faktin se ato dolën jashtë kuadrit familjar, farefisnor e të rrëthit miqësor jo vetëm si obligim moral e politik, por edhe si vendzhevillime, duke fituar hapësira të reja, duke zgjeruar gjeografinë e tyre: në fillim në Lis, pastaj në Burrel dhe më vonë edhe në Tiranë. Gjatë këtij “shtegtimi” përkujtimoret për Kujtim Frangun nuk kanë pasur vetëm rritje sasiore dhe hapësinore, por janë pasuruar edhe në përbajtje e në formë, në mënyrën e organizimit, në cilësinë e pjesëmarrjes dhe, mbi të gjitha, në pasurinë e mesazheve që kanë transmetuar.

Njëri prej folësve, Hamit Kurti, me këndvështrimin dhe vokacionin populor, shprehu një dëshirë që sot tingëllon si utopike, por që do të vijë dita që do të realizohet. Ai pak a shumë tha kështu: “Qendra e votimit asht e shejtë, ajo asht si kisha e si xhamia, ku njerëzit shkojnë e falen, ajo

asht si të gjitha falëtoret e vendet e tjera të shejta. Aty njeriu nuk duhet me ba hile, se e vret Zoti, se te qendra e votimit asht buka e fëmijëve tanë, asht e ardhmja jonë, e të gjithëve. Shyqyr që ia arritëm kësaj ditë me votue të lirë, se kemi vuejtë për votën e lirë, se na kanë vu para si bagëti me na çue në qendrat e votimit e me votue për kë donin ata. Prandaj vendvotimet tona sot duhet me qanë të shejta, në këto vende duhet me shkue jo me armë, por me zemër në dorë, me trup e shpirt të pastër, të zhveshun nga hilet e të këqijat...”

Këtë klimë që e mendon z.Kurti, duhet ta sjellë klasa jonë politike, pasi, siç është thënë me të drejtë “Një metodë më efikase për të pakësuar numrin dhe intensitetin e konflikteve në botë është shmangia e krijimit të situatave që shkaktojnë konfliktet”. Por kjo në vendin tonë nuk ka për t'u realizuar për një kohë të gjatë, prandaj mbetet aktuale mbrojtja e votës së lirë. Por si e qysh duhet bërë kjo, na vjen në ndihmëjeta e Kujtim Frangut. Për mendimin tim ai është militant partiak, por i një tipi të ri. Kujtim Frangu ishte i veçantë, se kishte dy cilësi, që rrallë njerëz i kanë: e para, ai ishte i pakorruptueshëm me asnje lloj çmimi; e dyta, ai nuk e shikonte politikën si një qëllim për t'u bërë i njojur, për t'u pasuruar apo për të arritur ndonjë objektiv personal. Ai e shikonte politikën si mjet për transformime demokratike, për ta futur Shqipërinë në

rrugën e përparimit.

Kujtim Frangu nuk hyri në politikë rastësisht, por përmes një seleksionimi prej disa dekadalash, pasi ai kishte qenë objekt i politikës qysh kur kishte lindur. Ai kishte qenë në opozitë me sistemin totalitar dhe kishte lufuar kundër tij me mënyra të ndryshme, qoftë edhe me heshtje. Duke qenë në këto kushte, ai u pajis me një forcë të madhe shpirtërore dhe morale.

Zgjedhjet, për mendimin tim, edhe në të ardhmen nuk do të jenë të ndershme dhe të drejta. Vota e lirë prapë ka nevoja për t'u mbrojtur. Por tashti ajo duhet mbrojtur nga paraja.

Sot paraja prodhon pushtet. Ajo korrupton jo vetëm komisionerët, por të gjithë ata që në një mënyrë ose në një tjetër, kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Në qendrat e votimit duhet të jenë ata që nuk mposhten nga forca e parasë. Kujtim Frangu do të ishte fort i dëshirueshëm sot dhe jo atë ditë kur kristë automatiku.

MEDIA E SHKRUAR PËR KUJTIM FRANGUN

Për Kujtim Frangun janë shkruar disa artikuj, kryesisht në gazetat e djathta, si: në "RD", "55", "Republika" etj. Shkrimet janë përgjithësisht të karakterit informativ, përkujtimore, me ç'rast edhe janë shkruar. Dy shkrimet e para janë thjesht lajme, i pari i botuar në "RD" menjëherë pas vrasjes, pikërisht me 8 korrik 1997, kurse i dyti është i gazetës "Republika".

Në këto shkrime kemi më shumë kronikën e ngjarjeve të përvjetoreve të ndryshëm, nga i pari e deri tek i gjashti. Në to thuhet se kush mori pjesë, kush foli dhe çfarë mesazhi përçolli etj. Ka edhe pak të dhëna biografike për jetën e Kujtimit dhe për familjen e tij, për mjedisin ku u rrit. Ato janë shkruar në valën e veprimtarive dhe, si pasqyrues të tyre, nuk mund të pritet më shumë. Nuk ka ndonjë shkrim për Kujtim Frangun si njeri, si prind, si intelektual, si mësues dhe personalitet shoqëror. Me gjithë këtë, kontributi i autorëve të tillë, si Neritan Kolgjini,

Dritan Gera, Mevlud Buci, Zef Lleshi, Halil Rama, Suleman Cakoni, Skënder Qendro, Hysni Cuka, etj., është i vlerësuar, se ka çuar në ndriçimin e figurës së Kujtim Frangut.

Këto shkrime, të marrë së bashku, plotësojnë njëri-tjetrin dhe na çojnë në disa përfundime:

Së pari, ato kanë të përbashkët mungesën e urrejtjes dhe të ndjenjës së hakmarrjes. Vrasja konsiderohet nga të gjithë politike dhe i “adresohet” jo vrasësit, por atyre që e ideuan atë. Asnjëri prej autorëve nuk përpinqet të japë qoftë edhe me pak detaje skenën e vrasjes së Kujtimit. Nuk besohet që ata të mos kenë ditur hollësira, por u janë shmangur atyre për arsyen njerëzore. Kjo është meritë e përbashkët e tyre.

Së dyti, krimin e ndodhur në Lis të Matit me 6 korrik 1997, të gjithë autorët e shikojnë si rrjedhojë e asaj situate kriminale që u krijuar në të gjithë Shqipërinë pas ngjarjeve tragjike të vitit 1997, kur armët ranë në duart e popullit.

Së terti, Kujtim Frangu vështrohet si dëshmor i votës së lirë dhe radhitet përkrah emrave të tjera, si: Azem Hajdari, Bujar Kaloshi, Lekë Qoku, Gjin Pali, Skënder Kalenja, Adem Shehu etj., të cilët, pavarësisht se nuk kanë qenë me kontribut të barabartë, kanë rënë për idealet e demokracisë dhe të përparimit të Shqipërisë.

Së katërti, me të drejtë autorët e shkrimeve jetën dhe

veprimtarinë e Kujtim Frangut e kanë parë të lidhur ngushte me familjen e tij dhe me edukatën e marrë prej saj, kanë nënvizuar atë harmoni zemrash që e bëri këtë familje jo vetëm të mbijetojë, por edhe të dalë e papërlyer nga “këneta” ku ishte zhytur për 50 vjet me radhë. Edhe familja Frangu nuk shikohet e vetmuar nga Lisi dhe nga Mati, nga patriotizmi, traditat dhe kultura matjane.

Së fundi, nëpërmjet aktit të rënies së Kujtim Frangut të gjithë autorët përcjellin mesazhin e domosdoshmërisë për ta ruajtur edhe në të ardhmen votën e lirë, pasi ajo do të jetë prapë e rrezikuar. Kjo ngarkesë “mesazhere” ka buruar jo vetëm nga qëndrimi i autorëve, por edhe i folësve në përkujtimore.

Po në një kapitull më parë dhamë një mendim se si dhe nga kush duhet të mbrohet vota e lirë. Këtu është me vend të theksoj se në vendin tonë ka nevojë të ngutshme të mobilizohen të gjithë faktorët politikë, shoqërorë, morale, kulturorë, historikë, fetarë, psikologjikë etj, etj., për të krijuar një klimë të favorshme dhe për të shkuar në zgjedhjet e ardhshme me një vullnet të përbashkët kombëtar për të votuar të lirë dhe për ta njojur verdiktin e popullit. Këtë mesazh mua ma imponon jo vetëm ndërgjegja dhe formimi im, por edhe heroï i librit. Kujtim Frangu nuk ishte Krishti, por mesazhi i “kryqëzimit” ndërsa shekuj është pasuruar me përmbajtje dhe kuptime të reja.



Kujtimi me familjen,
në radhën e parë, i treti, nga e majta.



Kujtimi 4 vjeç.



Kujtim Franga ushtar.



Kujtimi me babanë.




Kujtimi (djathtas) me një shok.




Kujtimi (i pari djathtas) mes kolegëve.



Kujtimi me një shok.



Kujtimi me vajzën e tij
Sabia.



Kujtimi me të vëllain,
Bajramin.




Kujtimi tek
“Liqejtë e
Lurës”.



Fëmijët e Kujtimit



Gjashtë mujori i rënies.



Përvjetori i rënies.




Fitnetja, bashkëshortja e
Kujtimit.



Vajza e Kujtimit, Sabia.



Familja e Kujtimit, tek varri i tij.



Nëna. gruaja dhe motra me dhimbje para varrit të Kujtimit.



Miqtë e tij në përvjetorin e rënies.





Shokë, miq dhe të afërm përkujtojnë Kujtim Frangun në
përvjetorin e tij të rënies.






Prof. Dr. Sali Berisha me familjen Frangu



Varri i Kujtim Frangun në Lis të Matit.



DIÇKA PËR MBYLLJE

Jeta

Kujtim Frangu jetoi pak. Po jeta nuk matet me vitet që jeton. Ajo nuk është shuma e viteve, por kualitet njerëzor. Mund të jetosh njëqind vjet dhe mund të mos bësh asgjë të madhe, të rëndësishme. Mund të jetosh pak dhe të bësh shumë. Historia e njerëzimit jep mjaft shembuj për ta ilustruar këtë. Shumë njerëz të shquar kanë vdekur të rinj. Kujtim Frangu hyn në radhët e tyre, natyrisht me përmasat e veta, me natyrën e vet dhe në kushtet dhe rrëthanat në të cilat punoi dhe jetoi, në atë hapësirë lirie që iu krijuar për ta shfaqur veten.

Ritmi

Të gjithë ata që kanë folur për Kujtimin, kanë nënvizuar një gjë, ai nuk pushonte kurrë, me përjashtim të

orëve të gjumit që nuk i ka bërë të plota. Ai nxitonë, ishte përherë në lëvizje. Të jetë kjo një rastësi, një prirje e karakterit të tij, apo do të ketë një vlerë dhe domethënë më të madhe? Njerëzve që vdesin të rinj, por që kanë një mision për të përm bushur, Zoti u ka dhënë aftësinë që ta kryejnë atë sa më shpejt. Tek këta njerëz ka ngutje, ka përsosmëri në punët që bëjnë, pasi nuk do të kenë kohë të rikthehen, të korrigojnë apo të limojnë diçka. Përsosmëria prej tyre arrihet me të parën. Zoti, duke ua shkurtuar kohën e të jetuarit, u ka shtuar ritmin, energjinë, përsosmërinë brenda limiteve të caktuara. Prandaj për ta nuk ka pushim e prehje në këtë botë. Ata nuk e lënë punën e sotme për nesër, por edhe të një minutë për një minut më vonë. Këtë nuk e bëjnë, ndoshta, me paramendim, por me intuitë. Por këtyre njerëzve u shkojnë edhe paralajmërimet hyjnore!. Në kujtimet e Tofikut kemi mësuar se Kujtimi i ka thënë se do të vdiste para tij. Ajo nuk ishte një shaka, se Kujtimi nuk i kishte të karakterit shaka të tilla. Ajo ishte një zbulësë, që i ka ardhur nga Zoti.

Mirësia

Njerëz si Kujtimi karakterizohen nga ndjenja miqësore, nga marrëdhënie shumë të mira me të tjérët. Ata kurdoherë komunikojnë me ciltërsi, në praninë e tyre

ndihesh mirë. Kujtimi ishte fjalëembël, nuk prishte qejf me njeri për aq sa ia lejonte hapësira e tij morale, për aq kohë sa nuk do t'i shkilje në disa gjëra të shenja dhe të shtrenjta. Këtë “ëmbëlsi” njerëzore të tjerët e manifestojnë në pleqërinë e thellë. Nuk thotë kot Holmësi se “Njerëzit janë si pjeshkët dhe si dardhat, që bëhen të ëmbla pak para se të prishen”. Kujtimi ëmbëlsinë dhe sjelljen e mirë e kishte veti të karakterit qysh në moshë fare të re.

Flijimi

Kujtimi ishte njeri që sakrifikonte për të tjerët. Ishte idealist në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Ndjenjën e flijimit e kishte në gjak. Ishte një flijim i ditëpërditshëm, i pabujshëm, në formën e thjeshtë të të gjendurit për të tjerët. Nëna e quante: “ I miri i shokëve”, se ai linte punën e vet për të mbaruar më parë të shokëve”. Fitorja e demokracisë ia rriti krahët idealizmit të tij, pasi ai nuk e dinte dhe, po ta dinte, nuk do ta besonte, atë që ka thënë Shantall Millon – Desal se “Politikisht liria çon në krye të shtetit ... jo më të mirët. Ekonomikisht liria ua le pushtetin egoistëve dhe të shkathtëve, të gatshëm për ta mbytur bashkësinë”. Kujtimi besonte tek lumiuria njerëzore, tek liria dhe kishte bindjen se ato do të vinin për të gjithë.

Falja

Kujtimi ishte nga ata që falte shumë. Asnjëherë nuk tregoi qoftë edhe shenjën më të vogël të hakmarrjes ndaj atyre që e kishin persekutuar. Nuk ishte mazohizëm. Ishte diçka shumë e madhe. Tomas thotë: “Njeriu që nuk ka vuajtur, nuk di të falë”. Kujtimi faljen e bënte për një jetë tjetër, më të bukur dhe më të mirë për të gjithë. E bënte në emër të së nesërmes. E dinte se me urrejtje nuk shkohet larg. Po tisjell prapë disa fjalë të Kujtimit: “Edhe ti, si Lala, nuk dini të falni... Duhet të falim ne që të pendohen të tjerët. Jemi të lirë nga shpirti dhe nga mendimet”.

Si e kuptione Kujtim Frangu Demokracinë

Nuk do të gjeja fjalë dhe shprehje më të bukur se sa atë që ka thënë Abraham Linkolni, ish-president i SHBA, dhe që i shkon shumë Kujtimit: “Aq sa nuk dua të jem skllav, po aq nuk dua të jem edhe zotëri. Kështu e kuptoj unë demokracinë. Gjithçka që nuk përputhet me këtë koncept, bie në kundërshtim me demokracinë”.

Vdekja

Ka shumë rëndësi si jeton, por më shumë rëndësi ka si vdes. “Vdekja tregon ç’neri ke qenë”, thotë një i ditur. Vdekjet më të bukura janë si ajo e Kujtimit, kur bije për një ideal të lartë, të përqafuar nga shumë njerëz. Mund të vritesh edhe në punë të liga dhe atëherë shkon si “Qeni në rrush”, siç thotë populli. Mund të vdesësh në shtrat dhe, sado i madh të kesh qenë, thonë “ndërroi jetë”, “u shua”, “u nda ngajeta” etj. Vdekja është e bukur kur ndodh për bukurinë e jetës. E tillë qe ajo e Kujtim Frangut. Zoti, kur don, të shpërbulen edhe me vdekjen!

PËRMBJAJTA E LËNDËS

Hyrje.....	3
Mati, vështrim i përgjithshëm.....	6
Lisi.....	9
Familja Frangu.....	13
Kujtim Frangu.....	18
Lufta e klasave në Lis.....	30
Familja, miqtë, shokët.....	49
Kujtim Frangu dhe proceset demokratike.....	68
Rënia e Kujtim Frangut.....	78
Përkujtimoret.....	89
Media e shkruar për Kujtim Frangun.....	95
Dicëka për mbyllje.....	110

